



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UJËSJELLËS KANALIZIME TIRANË SH.A
DREJTORIA E PROKURIMEVE
SEKTORI I INVESTIMEVE DHE PROJEKTEVE**

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ____/____/2020

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Për: Operatorin ekonomik “ARB & TRANS-2010” sh.p.k me NIPT L02325001T, me administrator Z. Fatmir Firi, me seli në Adresën: Tirane, Zall Herr Cerkeze-Morine, Ndertese 2 kateshe, 100 m larg ish Stallave Çekreze.

Lloji i procedurës së prokurimit: Procedurë e Hapur

Objekti i kontratës: “Ndërtim rrjet shpërndarës ujësjellësi në fshatin Qenam, Njësia Administrative Zall-Herr”

Numri i referencës së procedurës: REF-46654-12-23-2019

Fondi Limit: 24.321.690,5 (njëzet e katër milion e treqind e njëzet e një mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë presje pesë) lekë pa TVSH.

Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin: 60 (gjashtëdhjetë) ditë nga data e dorëzimit të sheshit të punimeve.

Afati kohor për dorëzimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje: 23.01.2020 Ora: 09:00

Buletini i Njoftimeve Publike: Nr. 52 DATE 30.12.2019

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: Çmimi më i ulët X oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik “Colombo” shpk NIPT-i J82916489E
Vlera: 18.586.789 (tetëmbëdhjetë milion e pesëqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e shtatëqind e tetëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH
2. Operatori ekonomik “BE-IS” shpk NIPT-it K71412003A
Vlera: 20.648.152 (njëzetë milion e gjashtëqind e dyzetë e tetë mijë e njëqind e pesëdhjetë e dy) lekë pa TVSH.
3. Operatori ekonomik “INA” sh.p.k NIPT-i J61814009W
Vlera: 21.742.265 (njëzet e një milion e shtatëqind e dyzetë e dy mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e pesë) lekë pa tvsh.

4. Operatori ekonomik **“ARB & TRANS-2010” sh.p.k** NIPT-i L02325001T
Vlera: 21.883.853,4 (njëzet e një milion e tetëqind e tetëdhjetë e tre mijë e tetëqind e pesëdhjetë e tre presje katër) lekë pa TVSH.
5. Operatori ekonomik **“KUPA” SHPK** NIPT-i K51615512C
Vlera: 22.922.106 (njëzet e dy milion e nëntëqind e njëzet e dy mijë e njëqind e gjashtë) lekë pa tvsh.
6. Operatori ekonomik **“Kacdedja”shpk** NIPT-i K51712017A
Vlera: 23.708.063,5 (njëzetë e tre milion e shtatëqind e tetë mijë e gjashtëdhjetë e tre presje pesë) leke pa tvsh.
7. Operatorëve ekonomik **“SHPRESA – AL“ sh.p.k** NIPT-i K31321021N
Vlera: 23.317.856 (njëzetë e tre milion e treqind e shtatëmbëdhjetë mijë e tetëqind e pesëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH.
8. Operatori ekonomik **“Ndertimi” sh.p.k** NIPT-i K11325002C
Vlera: 23.398.593 (njëzet e tre milion e treqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e tre) lekë pa tvsh.
9. peratori ekonomik **“Senka” sh.p.k** NIPT-i K11325002C
Vlera: 24.319.791 (njëzet e katër milion e treqind e nëntëmbëdhjetë mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e një) lekë pa tvsh.

Të skualifikuar, për arsyet si më poshtë:

1. **Operatori ekonomik “COLOMBO” SHP.K** me vlerë të ofertës **18.586.789** (tetëmbëdhjetë milion e pesëqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e shtatëqind e tetëdhjetë e nëntë)lekë pa TVSH.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi realizoi kontrollin për gabime aritmetike të ofertës së paraqitur në tender në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”I ndryshuar neni 66, konstatoi se oferta është paraqitur pa gabime aritmetike në vlera.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të Nenit 53 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin Publik”, (i ndryshuar), dhe të Kreut VII Nenit 66 pikës 3 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e rregullave të prokurimit publik”,I ndryshuar si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga ky Operator Ekonomik, nga ku rezultoi si më poshtë:

Së pari: AK në kriteret e veçanta të kualifikimit ka kërkuar si më poshtë cituar:

4.Një punësim mesatar i të paktën 60 (gjashtëdhjetë) personave, për periudhën Dhjetor 2018- Nëntor 2019 të vërtetuar me;

Punonjësit e sipërcituar duhet të jenë të siguruar me ditë të plota pune.

4.1Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet shoqerore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj; per periudhen Dhjetor 2018- Nëntor 2019.

4.2 List pagesat e punonjesve sipas formatit qe kerkohet nga legjislacioni ne fuqi per periudhen

Dhjetor 2018- Nëntor 2019.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik në sistemin elektronik të app-se verën se:

Operatori ekonomik ka paraqitur si më poshtë cituar:

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur në sistemin elektronik të app-së (listpagesat e shoqërisë për periudhën Dhjetor 2018- Nëntor 2019) të shoqërisë “COLOMBO” SHP.K rezulton se punonjës të siguruar me kohë të plotë pune për periudhën e sipërcituar disponon vetëm 27 punonjës përkatësisht si mëposhtë vijon:

- Listëpagesa e punonjesve për periudhën Dhjetor 2018 - 18 punonjës të siguruar me ditë të plota pune.
- Listëpagesa e punonjesve për periudhën Janar 2019 - 27 punonjës të siguruar me ditë të plota pune.
- Listëpagesa e punonjesve për periudhën Shkurt 2019 - 31 punonjës të siguruar me ditë të plota pune.
- Listëpagesa e punonjesve për periudhën Mars 2019 - 34 punonjës të siguruar me ditë të plota pune.
- Listëpagesa e punonjesve për periudhën Prill 2019 - 32 punonjës të siguruar me ditë të plota pune.
- Listëpagesa e punonjesve për periudhën Maj 2019 - 27 punonjës të siguruar me ditë të plota pune.
- Listëpagesa e punonjesve për periudhën Qershor 2019 - 29 punonjës të siguruar me ditë të plota pune.
- Listëpagesa e punonjesve për periudhën Korrik 2019 - 28 punonjës të siguruar me ditë të plota pune.
- Listëpagesa e punonjesve për periudhën Gusht 2019 - 22 punonjës të siguruar me ditë të plota pune.
- Listëpagesa e punonjesve për periudhën Shtator 2019 - 26 punonjës të siguruar me ditë të plota pune.
- Listëpagesa e punonjesve për periudhën Tetor 2019 - 26 punonjës të siguruar me ditë të plota pune.
- Listëpagesa e punonjesve për periudhën Nëntor 2019 - 24 punonjës të siguruar me ditë të plota pune.

Operatori ekonomik “COLOMBO” SH.P.K i cili duhet të paraqiste 60 punonjës të siguruar me kohë të plotë pune, nga listpagesat e sipërpermendura rezulton një numër mesatar prej 27 punonjësish të siguruar me ditë të plota pune, Për rrjedhojë nuk ka përmbushur kriterin e paraqitjes së nr të punonjësve.

Pra sa më sipër OE “COLOMBO” SHP.K nuk zotëron kapacitet të mjaftueshëm teknik për sa i përket **personelit të nevojshëm** për të realizuar kontratën për këtë objekt prokurimi duke mos përmbushur Kriteret e veçanta për kualifikim, Kapaciteti Teknik dhe profesional, , cka bie në kundërshtim me pikën 1 gërma (a) dhe (b) të nenit 46 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar ku përcaktohet se: *Operatorët ekonomik, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtëme që AK i vlerëson të nevojshme.....*

*b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, **si dhe personelin e***

Ujësjejlës Kanalizime sh.a. Tiranë NIPT L72320033P Adresa: Rruga e Kavajës Nr.133, Njësia administrative Nr.6,
Kodi postar 1027, Tiranë, Shqipëri, Tel: 00 355 42240978,info@ukt.al.

nevojshëm,për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;

Pra sa më sipër cituar dokumentacioni i paraqitur nga Operatori Ekonomik lidhur me numrin e punonjësve, është i paplotë.

Së dyti AK ka kërkuar në kriteret e veçanta të kualifikimit si më poshtë cituar:

14.Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratë (Shtojca 10).

Mjetet	Sasia	Gjendja
Kamionçine (kapaciteti mbajtës minimum 1.5(nje pik pesë) ton dhe maksimumi 2(dy) ton për secilin kamionçinë	4 cope	Pronësi ose me qera

- Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, Çertifikatë për transport mallrash për llogari të vetë dhe siguracionin e mjetit (te vlefshme), dhe për mjetet e siguruar me qera, dokumenti që verteton regjistrimin e tij plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit,(te vlefshme) Çertifikatë për transport mallrash për të tretë dhe me qera brenda vendit, duhet të shoqërohet me kontratën perkatese të qerave/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi. Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jene aktet e çdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.*
- Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre.*
- Për mjetet e marra me qera të të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj.*
- Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.*
- Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara sipas shtojcës Nr. 10. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese).*
- Makineritë e mësipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë të deklaruara ne procedurat të shpallura fitues nga autoriteti kontraktor, UKT sha. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese ku të deklarohet dhe vendndodhja e mjeteve në pronësi ose me qera me qellim verifikimi).*
- (opsion) Do të organizohet një vizitë në kantier deri në date 16.01.2019 në mënyrë të tillë që Operatorët Ekonomikë të mund të familiarizohen me kushtet lokale. Operatori i interesuar Ekonomik duhet të konfirmojë paraprakisht me shkrim synimin e tij për të marrë pjesë në këtë vizitë. Gjatë vizitës do t'u jepen informacione shtesë e shpjegime. Të gjitha kostot e Operatorëve Ekonomikë që lidhen me vizitën në kantier duhet të mbulohen nga vetë ata. Pa paragjykuar sa më sipër, dhe me kostot e risqet e veta, një operator ekonomik mund t'a vizitojë në çdo kohë vendndodhjen e kantierit, nëse një gjë e tillë është e mundur.
Për të organizuar një vizitë në kantier, ju lutem drejtoni një shkresë prane Drejtorise se Prokurimit UKT sha.*

Operatori ekonomik “COLOMBO” sh.p.k ka deklaruar në shtojcën nr.10 se disponon mjetet e mëposhtme Për këtë kategori:

- Kamioncina me targa VL9884A** e cila sipas lejes së qarkullimit rezulton të jetë me kapacitet

Ujësjiellës Kanalizime sh.a. Tiranë NIPT L72320033P Adresa: Rruga e Kavajës Nr.133, Njësia administrative Nr.6,
Kodi postar 1027, Tiranë, Shqipëri, Tel: 00 355 42240978,info@ukt.al.

mbajtes 1.5 ton. **(do konsiderohet i rregullt dhe do futet në kategorinë me kapacitet mbajtës 1.5-2 ton)**

- b) Kamioncina me targa **VL6465B** e cila sipas lejes së qarkullimit rezulton të jetë me kapacitet mbajtes 1.8 ton. **(do konsiderohet i rregullt dhe do futet në kategorinë me kapacitet mbajtës 1.5-2 ton)**
- c) Kamioncina me targa **AA4416KL** e cila sipas lejes së qarkullimit rezulton të jetë me kapacitet mbajtes 1.46 ton .
- d) Kamioncina me targa **AA335XF** e cila sipas lejes së qarkullimit rezulton të jetë me kapacitet mbajtes 1.7 ton. I siguruar nëpërmjet kontratës së qerasë Nr.179 rep, nr. 95 kol, datë 21.01.2020.

Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit në sistemin elektronik për mjetin me targa AA335XF operatori ekonomik ka paraqitur leje qarkullimi, çertifikatë e kontrollit teknik, taksë vjetore, foto të mjetit si dhe çertifikatë për transport mallrash për llogari të vet.

Ajo çka konstaton Komisioni i Vlerësimit të Ofertave është se çertifikatat e lëshuar nga njësia vendore për transport mallrash është cilësuar “Për llogari të vet, pra qeradhënësi e ka për përdorim vetjak.

Dhënia e tyre me qera është në kundërshtim me përcaktimet në nenin 81, pika 1,2,3,4,5 dhe 7,8 “Destinacioni dhe Përdorimi i Mjeteve” i ligjit nr.8378 datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenin 3, paragrafi 3.13 dhe 3.14 të Ligjit nr.8308, datë 18.3.1998 për “Transportet rrugore”, si dhe në nenin 41, të Ligjit nr.8308, datë 18.3.1998 për “Transportet rrugore”, ku parashikohet se: “Transporti i mallrave me qira dhe për të tretë është i ndaluar të kryhet pa licencën përkatëse.

Përsa cituam më lart paraqitja e dokumentacionit lidhur me këtë mjet do të konsiderohet i pasaktë dhe për rrjedhojë do të konsiderohet i pavlefshëm.

- e) Kamioncina me targa **VL4533B** e cila sipas lejes së qarkullimit rezulton të jetë me kapacitet mbajtes 2 ton. **(do konsiderohet i rregullt dhe do futet në kategorinë me kapacitet mbajtës 1.5-2 ton)**

Sa më sipër cituar operatori ekonomik nuk e përmbush kriterin e përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit për:

- Paraqitjen e 4 mjeteve me kapacitet mbajtës min 1,5 ton dhe max 2 ton pasi nga 4 (katër) kamionçina të kërkuar, shoqëria ka paraqitur me dokumentacion të rregullt në përmbushje të këtij kriteri 3 (tre) kamionçina, përkatësisht mjetet me Targa VL9884A, VL6465B, VL4533B .

Gjykojmë se është barrë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, të vërtetojë se disponon kapacitetet teknike në lidhje **me mjetet**. Sqarojmë se, kriteri për mjetet duhet parë dhe vlerësuar në tërësinë e tij, me të gjithë elementët e kërkuar dhe përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit. Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me

sukses të kontratës. Në rastin konkret, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron kapacitetet teknike (makineritë), në përputhje me volumnin e përcaktuar në dokumentat e tenderit. Në këto kushte, vlerësojmë se kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor në pikën 14 të shtojcës 12, “Kapaciteti teknik”, në dokumentat standarte të tenderit, nuk mund të konsiderohet i përmbushur, në lidhje kamioncinat 1.5 – 2 ton.

Për sa më sipër Dokumentacioni i paraqitur nga Operatori Ekonomik “është i paplotë pasi nuk ka përmbushur kriteret e Veçanta të Kualifikimit/ Kapaciteti Teknik nuk zotëron kapacitet të mjaftueshem teknik për sa i përket mjeteve për të realizuar kontratën për këtë objekt prokurimi duke mos përmbushur Kriteret e veçanta për kualifikim, Kapaciteti Teknik dhe profesional, , cka bie në kundërshtim me pikën 1 gërma (a) dhe (b) të nenit 46 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar ku përcaktohet se: *Operatorët ekonomik, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtëme që AK i vlerëson të nevojshme.....*

Pra sa më sipër cituar dokumentacioni i paraqitur nga Operatori Ekonomik lidhur me shtojcën 10, është i paplotë.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar dhe mbështetje të Kreu VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **e shpall të pavlefshme** këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

2. Oferta e paraqitur nga operatori ekonomik “Kacdedja sh.p.k” me vlerë 23.708.063,5 (njëzetë e tre milion e shtatëqind e tetë mijë e gjashtëdhjetë e tre presje pesë) leke pa tvsh.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi realizoi kontrollin për gabime aritmetike të ofertës së paraqitur në tender në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar neni 66, konstatoi se oferta është paraqitur pa gabime aritmetike në vlera.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të Nenit 53 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin Publik”, (i ndryshuar), dhe të Kreut VII Neni 66 pikës 3 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga ky Operator Ekonomik, nga ku rezultoi si më poshtë:

Së pari AK ka kërkuar në kriteret e veçanta të kualifikimit si më poshtë cituar:

14.Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratë (Shtojca 10).

<i>Mjetet</i>	<i>Sasia</i>	<i>Gjendja</i>
Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 3.5(tre pike pese) ton dhe maksimumi 5 (pese) ton për secilin kamion	3 copë	Pronësi ose me qera
Fadrome me goma	1 copë	Pronësi ose me qera
Eskavator me goma 0.25 m3	1 copë	Pronësi ose me qera

Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 12(dymbëdhjetë) ton dhe maksimumi 17(shtatëmbëdhjetë) ton për secilin kamion	3 copë	Pronësi ose me qera
Autobot uji	1 copë	Pronësi ose me qera
Autobetoniere	1 copë	Pronësi ose me qera
Autovinc	1 cope	Pronësi ose me qera
Pompë uji	1 copë	Pronësi ose me qera
Kamionçinë (kapaciteti mbajtës minimum 1.5(nje pik pesë) ton dhe maksimumi 2(dy) ton për secilin kamionçinë	4 cope	Pronësi ose me qera
Vibrator	1 cope	Pronësi ose me qera
Matrapik	1 cope	Pronësi ose me qera
Motogjenerator	1 cope	Pronësi ose me qera
Saldatrice	1 cope	Pronësi ose me qera

Te paraqiten mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit si më poshtë:

- Kokore minimumi 60 copë
 - Rripa lidhës sigurimi për punime në lartësi minimumi 5 copë
 - Fikëse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra secila minimumi 5 copë
 - Prozhektorë ndriçimi natën minimumi 4 copë
 - Komplet i ndimës së shpejtë minimumi 5 copë
 - Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 10 copë
- a) *Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, Certifikatë për transport mallrash për llogari të vetë dhe siguracionin e mjetit (te vlefshme), dhe për mjetet e siguruar me qera, dokumenti që verteton regjistrimin e tij plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit, (te vlefshme) Certifikatë për transport mallrash për të tretë dhe me qera brenda vendit, duhet të shoqerohet me kontratën perkatese të qerash/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi. Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jenë aktet e çdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.*
 - b) *Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre.*
 - c) *Për mjetet e marra me qera të të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj.*
 - d) *Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.*
 - e) *Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruar sipas shtojcës Nr. 10. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese).*
 - f) *Makineritë e mësipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë të deklaruar në procedurat të shpallura fitues nga autoriteti kontraktor, UKT sha. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese ku të deklarohet dhe vendndodhja e mjeteve në pronësi ose me qera me qellim verifikimi).*

g) (opsion) Do të organizohet një vizitë në kantier deri në datë 16.01.2019 në mënyrë të tillë që Operatorët Ekonomikë të mund të familiarizohen me kushtet lokale. Operatori i interesuar Ekonomik duhet të konfirmojë paraprakisht me shkrim synimin e tij për të marrë pjesë në këtë vizitë. Gjatë vizitës do t'u jepen informacione shitesë e shpjegime. Të gjitha kostot e Operatorëve Ekonomikë që lidhen me vizitën në kantier duhet të mbulohen nga vetë ata. Pa paragjykuar sa më sipër, dhe me kostot e risqet e veta, një operator ekonomik mund t'a vizitojë në çdo kohë vendndodhjen e kantierit, nëse një gjë e tillë është e mundur.

Për të organizuar një vizitë në kantier, ju lutem drejtoni një shkresë prane Drejtorise së Prokurimit UKT sha.

Operatori ekonomik **“Kacdedja” sh.p.k** ka deklaruar në shtojcën nr.10 se disponon mjetet e mëposhtme:

- Kamioncina me targa **AA479EU** e cila sipas lejes së qarkullimit rezulton të jetë me kapacitet mbajtes **0.47 ton**.
- Kamion me targa **AA263FK** e cila sipas lejes së qarkullimit rezulton të jetë me kapacitet mbajtes **25 Ton**.
- Kamion me targa **AA761BC** e cila sipas lejes së qarkullimit rezulton të jetë me kapacitet mbajtes 3,54 ton mjet I siguruar nëpërmjet kontratës së Huapërdorjes datë 16.07.2019.

(AK ka konstatuar se nuk është ngarkuar në sistemin elektronik të APP certifikata për transport malli duke mos përmbushur në këtë mënyrë kriterin e kerkuar në DST/KAPACITETI TEKNIK pika ku kerkohet paraqija e certifikates për transport malli në rastin e qerases për të trete, certifikata e paraqitur për këtë mjet është për llogari të huadhenesit).

- Kamion me targa **AA148XC** e cila sipas lejes së qarkullimit rezulton të jetë me kapacitet mbajtes **4.6 ton** mjet I siguruar nëpërmjet kontratës së Huapërdorjes datë 30.09.2019.

(AK ka konstatuar se nuk është ngarkuar në sistemin elektronik të APP certifikata për transport malli duke mos përmbushur në këtë mënyrë kriterin e kerkuar në DST/KAPACITETI TEKNIK pika ku kerkohet paraqija e certifikates për transport malli në rastin e qerases për të trete, certifikata e paraqitur për këtë mjet është për llogari të huadhenesit).

- Kamion me targa **AA460 OS** e cila sipas lejes së qarkullimit rezulton të jetë me kapacitet mbajtes **6.1 ton** mjet I siguruar nëpërmjet kontratës së Huapërdorjes datë 02.07.2019.

Gjithashtu AK ka konstatuar se nuk është ngarkuar në sistemin elektronik të APP certifikata për transport malli duke mos përmbushur në këtë mënyrë kriterin e kerkuar në DST/KAPACITETI TEKNIK pika ku kerkohet paraqija e certifikates për transport malli në rastin e qerases për të trete

2. Kamion me targa **TR5106R** e cila sipas lejes së qarkullimit rezulton të jetë me kapacitet mbajtes 19.4 ton mjet I siguruar nëpërmjet kontratës së Huapërdorjes datë 26.04.2018

(AK ka konstatuar se nuk është ngarkuar në sistemin elektronik të APP certifikata për transport malli duke mos përmbushur në këtë mënyrë kriterin e kerkuar në DST/KAPACITETI TEKNIK pika ku kerkohet paraqija e certifikates për transport malli në rastin e qerases për të trete, certifikata e paraqitur për këtë mjet është për llogari të huadhenesit).

- Kamion me targa **AA386NJ** e cila sipas lejes së qarkullimit rezulton të jetë me kapacitet mbajtes 16.8 ton mjet i siguruar nëpërmjet kontratës së Huapërdorjes datë 02.07.2019 për të cilën konstatohet se mungon certifikata për transport mallrash.
- Autovinç me targa **TR9082T** e cila sipas lejes së qarkullimit rezulton të jetë me kapacitet

mbajtes **8 ton** mjet I siguruar nëpërmjet kontratës së Huapërdorjes datë 06.06.2018

- Kamioncina me targa **AA0422M** e cila sipas lejes së qarkullimit rezulton të jetë me kapacitet mbajtes **2.7 ton** mjet I siguruar nëpërmjet kontratës së Huapërdorjes datë 02.07.2019.
- Kamioncina me targa **TR1952T** e cila sipas lejes së qarkullimit rezulton të jetë me kapacitet mbajtes 0.96 ton .
- Kamioncina me targa **AA2530X** e cila sipas lejes së qarkullimit rezulton të jetë me kapacitet mbajtes 1.05 ton .
- Kamioncina me targa **AA637OD** e cila sipas lejes së qarkullimit rezulton të jetë me kapacitet mbajtes 1.9 ton mjet I siguruar nëpërmjet kontratës së Huapërdorjes datë 16.09.2019. Gjithashtu AK ka konstatuar se nuk është ngarkuar në sistemin elektronik të APP certifikata për transport malli duke mos përmbushur në këtë mënyrë kriterin e kërkuar në DST/KAPACITETI TEKNIK pika ku kërkohej paraqitja e certifikates për transport malli në rastin e qerave për të tretë.

Nga sa me sipër mjetet me targa AA761BC, AA148XC, AA460 OS, TR5106R AA386NJ, TR9082T, AA0422M, AA637OD janë siguruar nëpërmjet kontratës së Huapërdorjes.

Ajo çka konstaton Komisioni i Vlerësimit të Ofertave është se certifikatat e lëshuara për mjetet e mësipërme nga njësia vendore për transport mallrash janë cilësuar “Për llogari të vet, pra huadhenesi e ka për përdorim vetjak.

Dhënia e tyre me qera është në kundërshtim me përcaktimet në nenin 81, pika 1,2,3,4,5 dhe 7,8 “Destinacioni dhe Përdorimi i Mjeteve” i ligjit nr.8378 datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenin 3, paragrafi 3.13 dhe 3.14 të Ligjit nr.8308, datë 18.3.1998 për “Transportet rrugore”, si dhe në nenin 41, të Ligjit nr.8308, datë 18.3.1998 për “Transportet rrugore”, ku parashikohet se: “Transporti i mallrave me qira dhe për të tretë është i ndaluar të kryhet pa licencën përkatëse.

Referuar kritereve të vendosura nga Autoriteti kontraktor konstatohet se të gjitha mjetet janë kërkuar në pronësi ose me qera dhe në asnjë rast nuk është përcaktuar që mjetet mund të paraqiten me kontratë huapërdorje.

Pra sa më sipër komisioni i vlerësimit të ofertave gjykon se operatori ekonomik nuk siguron nëpërmjet kontratës së huapërdorjes disponueshmërinë e mjetve për gjatë gjithë kohës së realizimit të kontratës. KVO referuar kërkesës të vendosur nga autoriteti kontraktor që mjetet duhet të jenë në pronësi ose me qera si dhe referuar Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë “kontrata e qerave” është një veprim juridik ndryshe nga “kontrata e huapërdorjes”, të cilat ligjvënësi i trajton në dispozita të veçanta me specifikat e tyre, marrëdhëniet juridike që rregullojnë dhe pasojat (të drejtat dhe detyrimet) për çdo palë pjesëmarrëse dhe nënshkruese të këtyre kontratave.

Kontrata e qerave është një kontratë me të cilën njëra palë (qeradhënësi) detyrohet ti japë palës tjetër (qeramarrësit) një send të caktuar në gëzim të përkohshëm kundrejt një shpërblimi të caktuar. (Neni 801 i KC)

Në Kreun IX, “Kontrata e Huapërdorjes”, Neni 901 citohet sa më poshtë:

Me kontratën e huapërdorjes, njëra palë (huadhënësi) i jep palës tjetër (huamarrësit), pa kundërshtpërblim, një send të caktuar që ta përdorë përkohësisht dhe kjo palë detyrohet ta kthejë atë send në afatin e caktuar në kontratë. Kur nuk është caktuar afat, sendi kthehet me kërkesën e Palës që ka dhënë sendin.

Neni 907

Në qoftë se gjatë afatit të caktuar, ose përpara se huamarrësi të ketë pushuar së përdoruri sendin sipas kontratës, huadhënësi ndodhet përpara nevojës së ngutshme dhe të paparashikuar të sendit, ai mund të kërkojë zgjidhjen e kontratës dhe kthimin e menjëhershëm të sendit.

Pra referuar dhe në kuptim të dispozitës sipërcituar, operatori ekonomik nuk siguron nëpërmjet kontratës së huapërdorjes disponueshmërinë e mjetit për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës pasi në çdo moment sendi mund ti kthehet huadhënesit me kërkesën e këtij të fundit (si një e drejtë legjitime të cilën e sanksionon Kodi Civil) edhe gjatë kohës që kontrata mund të jetë në vazhdim.

Pra referuar sa më sipër, duke paraqitur kontrata Huapërdorje për mjetet operatori ekonomik nuk plotëson kriterin e vendosur nga Autoriteti Kontraktor ku specifikisht kerkohet që mjetet që të jenë në pronësi ose me qira, dhënia në huapërdorje është në kundërshtim me rregullat e Kodit Rrugor, ku parashikohet se përdorimi nga të tretët i automjeteve përfshin dhënien me qira të tyre pa drejtues mjeti dhe në asnjë rast nuk pranohet dhënia e automjeteve në huapërdorje gjithashtu vlen të theksohet se operatori ekonomik nuk siguron nëpërmjet kontratës së huapërdorjes disponueshmërinë e mjetit për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës pasi në çdo moment sendi mund ti kthehet huadhënesit me kërkesën e këtij të fundit **Sa më sipër cituar operatori ekonomik nuk e përmbush kriterin e përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit për:**

- Paraqitjen e 4 kamionëçinave me kapacitet mbajtës **min 1.5 ton dhe max 2 ton** pasi nga 4 (katër) kamionçina të kërkuar, shoqëria nuk ka paraqitur me dokumentacion të rregullt në përmbushje të këtij kriteri asnjë kamionçinë.
- Paraqitjen e 3 kamionëve me kapacitet mbajtës **min 3.5 ton dhe max 5 ton** pasi nga 3 (tre) kamiona të kërkuar, shoqëria nuk ka paraqitur me dokumentacion të rregullt në përmbushje të këtij kriteri asnjë kamion.
- Paraqitjen e 3 kamionëve me kapacitet mbajtës **min 12 ton dhe max 17 ton** pasi nga 3 (tre) kamiona të kërkuar, shoqëria nuk ka paraqitur me dokumentacion të rregullt në përmbushje të këtij kriteri asnjë kamion.

Gjykojmë se është barrë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, të vërtetojë se disponon kapacitetet teknike në lidhje **me mjetet**. Sqarojmë se, kriteri për mjetet duhet parë dhe vlerësuar në tërësinë e tij, me të gjithë elementët e kërkuar dhe përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit. Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës. Në rastin konkret, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron kapacitetet teknike (makineritë), në përputhje me volumin e përcaktuar në dokumentat e tenderit. Në këto kushte, vlerësojmë se kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor në pikën 14 të shtojcës 12, “Kapaciteti teknik”, në dokumentat standarte të tenderit, nuk mund të konsiderohet i përmbushur, në lidhje me kamionat me kapacitet mbajtës min 3,5 dhe max 5 kamionat vetshkarkues me kapacitet mbajtës min 12 dhe max 17 ton. si dhe kamioncinat 1.5 – 2 ton.

Për sa më sipër Dokumentacioni i paraqitur nga Operatori Ekonomik “është i paplotë pasi nuk ka përmbushur kriteret e Veçanta të Kualifikimit/ Kapaciteti Teknik nuk zotëron kapacitet të mjaftueshem teknik për sa i përket mjeteve për të realizuar kontratën për këtë objekt prokurimi

duke mos përmbushur Kriteret e veçanta për kualifikim, Kapaciteti Teknik dhe profesional, , cka bie në kundërshtim me pikën 1 gërma (a) dhe (b) të nenit 46 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar ku përcaktohet se: *Operatorët ekonomik, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtëme që AK i vlerëson të nevojshme.....*

Pra sa më sipër cituar dokumentacioni i paraqitur nga Operatori Ekonomik lidhur me shtojcën 10, është i paplotë.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar dhe mbështetje të Kreu VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **e shpall të pavlefshme** këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

3. Oferta e paraqitur nga Operatori Ekonomik “SHPRESA – AL“ sh.p.k me vlerë të ofertës 23.317.856 (njëzetë e tre milion e treqind e shtatëmbëdhjetë mijë e tetëqind e pesëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi realizoi kontrollin për gabime aritmetike të ofertës së paraqitur në tender në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar neni 66, konstatoi se oferta është paraqitur pa gabime aritmetike në vlera.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të nenit 53 të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe Kreut VII, neni 66, pika 3 të VKM Nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga ky Operator ekonomik, nga ku rezultoi si më poshtë:

Së pari: AK ka kërkuar në kriteret e veçanta të kualifikimit kapaciteti teknik pika 9 si më poshtë cituar:

9. Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar si staf mbështetës për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, me dëshmi kualifikimi profesional të leshuar nga subjektet e akredituar, si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit stafi si më poshtë:

- 2 (dy) hidraulik
- 1 (një) saldator
- 1 (një) elektrikist
- 1 (një) specialist për montim tubash

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjatë shqyrtimit të dokumentacionit në sistemin elektronik vëren se në përmbushje të kriterit të sipërcituar operatori ekonomik ka paraqitur punonjësit e mëposhtëm:

- H.D për të cilin ka paraqitur dëshmi të kualifikimit të sigurimit teknik për (hidraulik)
- A.L për të cilin ka paraqitur dëshmi të kualifikimit të sigurimit teknik për (hidraulik)

- GJ.M për të cilin ka paraqitur dëshmi të kualifikimit të sigurimit teknik për (saldator)

- F.GJ për të cilin ka paraqitur dëshmi të kualifikimit të sigurimit teknik për (elektricitist)

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur komisioni i vlerësimit të ofertave evidenton se operatori ekonomik nuk ka arritur të paraqesë dëshmi profesionale ashtu siç është kërkuar në kriteret e veçanta të kualifikimit.

Sqarojmë operatorin ekonomik se dëshmitë e kualifikimit profesional dhe dëshmitë e kualifikimit të sigurimit teknik janë të ndryshme nga njëra tjetra dhe lëshohen nga institucione të ndryshme.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave thekson se kualifikimi i sigurimit teknik bëhet në përputhje me nenin 9 pika 1.gërma a)të ligjit nr.8734,datë 01.07.2001”Për garantimin e sigurisë së punës së pajisjeve dhe instalimeve elektrike në të cilën parashikohet se....Punëdhënësi merr masat e nevojshme që:

a) përdorimi i pajisjeve elektrike të bëhet nga punëmarrës që kanë përgatitje të

mjaftueshme, të dokumentuar me dëshmi aftësie, e lëshuar nga IPIE-ja ose nga komisioni i miratuar prej saj;

e cila ka të bëjë me trajnimin e punonjësve për përdorimin e pajisjeve elektrike ,pavarësisht profesionit që mund të kenë.

Ndërsa dëshmia e kualifikimit profesional ka të bëjë me profesionin e secilit punonjës të cilat lëshohen nga institucione të ndryshme dhe që në asnjë rast nuk janë të njëjta me ato që lëshojnë dëshmitë e kualifikimit të sigurimit teknik.

Përsa cituam më lart dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik “SHPRESA – AL“ sh.p.k do të konsiderohet i paplotë dhe për rrjedhojë i pavlefshëm.

Në shtojcën 11 shprehimisht parashikohet se....**Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.**

Së dyti: AK ka kërkuar në kriteret e veçanta të kualifikimit kapaciteti teknik pika 14 si më poshtë cituar:

14.Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratë (Shtojca 10).

<i>Mjetet</i>	<i>Sasia</i>	<i>Gjendja</i>
Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 3.5(tre pike pese) ton dhe maksimumi 5 (pese) ton për secilin kamion	3 copë	Pronësi ose me qera
Fadrome me goma	1 copë	Pronësi ose me qera
Eskavator me goma 0.25 m3	1 copë	Pronësi ose me qera
Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 12(dymbëdhjetë) ton dhe maksimumi 17(shtatëmbëdhjetë) ton për secilin kamion	3 copë	Pronësi ose me qera
Autobot uji	1 copë	Pronësi ose me qera

Autobetoniere	1 copë	Pronësi ose me qera
Autovinc	1 cope	Pronësi ose me qera
Pompë uji	1 copë	Pronësi ose me qera
Kamionçine (kapaciteti mbajtës minimum 1.5(nje pik pesë) ton dhe maksimumi 2(dy) ton për secilin kamionçinë	4 cope	Pronësi ose me qera
Vibrator	1 cope	Pronësi ose me qera
Matrapik	1 cope	Pronësi ose me qera
Motogjenerator	1 cope	Pronësi ose me qera
Saldatrice	1 cope	Pronësi ose me qera

Te paraqiten mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit si më poshtë:

- Kokore minimumi 60 copë
- Rripa lidhës sigurimi për punime në lartësi minimumi 5 copë
- Fikëse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra secila minimumi 5 copë
- Prozhektorë ndriçimi natën minimumi 4 copë
- Komplet i ndimës së shpejtë minimumi 5 copë
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 10 copë

- a)** *Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, Certifikatë për transport mallrash për llogari të vetë dhe siguracionin e mjetit (te vlefshme), dhe për mjetet e siguruar me qera, dokumenti që verteton regjistrimin e tij plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit, (te vlefshme) Certifikatë për transport mallrash për të tretë dhe me qera brenda vendit, duhet të shoqerohet me kontratën perkatese të qerave/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi. Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jenë aktet e çdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.*
- b)** *Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre.*
- c)** *Për mjetet e marra me qera të të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj.*
- d)** *Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.*
- e)** *Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruar sipas shtojcës Nr. 10. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese).*
- f)** *Makineritë e mësipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë të deklaruar në procedurat të shpallura fitues nga autoriteti kontraktor, UKT sha. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese ku të deklarohet dhe vendndodhja e mjeteve në pronësi ose me qera me qellim verifikimi).*
- g)** *(opsion) Do të organizohet një vizitë në kantier deri në datë 16.01.2019 në mënyrë të tillë që Operatorët Ekonomikë të mund të familiarizohen me kushtet lokale. Operatori i interesuar Ekonomik duhet të konfirmojë paraprakisht me shkrim synimin e tij për të marrë pjesë në këtë vizitë. Gjatë vizitës do t'u jepen informacione shtesë e shpjegime. Të gjitha kostot e Operatorëve Ekonomikë që lidhen me vizitën në kantier duhet të mbulohen nga vetë ata. Pa*

paragjykuar sa më sipër, dhe me kostot e risqet e veta, një operator ekonomik mund t'a vizitojë në çdo kohë vendndodhjen e kantierit, nëse një gjë e tillë është e mundur.
Për të organizuar një vizitë në kantier, ju lutem drejtoni një shkresë prane Drejtorise se Prokurimit UKT sha.

Operatori ekonomik **“SHPRESA – AL“ sh.p.k** ka deklaruar në shtojcën nr.10 se disponon mjetet e mëposhtme:

1.Kamion me targa TR8680L

Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit, në sistemin elektronik për mjetin e mësipërm operatori ekonomik Nuk ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar sipas kriterit të sipërcituar për mjetin (leje qarkullimi, çertifikatë e kontrollit teknik, taksë vjetore, foto të mjetit si dhe çertifikatë për transport mallrash për llogari të vet.....

2.Kamion me targa AA617NS

Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit, në sistemin elektronik për mjetin e mësipërm operatori ekonomik Nuk ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar sipas kriterit të sipërcituar për mjetin (leje qarkullimi, çertifikatë e kontrollit teknik, taksë vjetore, foto të mjetit si dhe çertifikatë për transport mallrash për llogari të vet.....

3.Autovinç me targa AA348LA e cila sipas lejes së qarkullimit rezulton të jetë me kapacitet mbajtës 7.8 ton.

Sa më sipër cituar operatori ekonomik nuk e përmbush kriterin e përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit për:

- Paraqitjen e 4 kamionëçinave me kapacitet mbajtës **min 1.5 ton dhe max 2 ton** pasi nga 4 (katër) kamionçina të kërkuar, shoqëria nuk ka paraqitur me dokumentacion të rregullt në përmbushje të këtij kriteri asnjë kamionçinë.
- Paraqitjen e 3 kamionëve me kapacitet mbajtës min 3.5 ton dhe max 5 ton pasi nga 3 (tre) kamiona të kërkuar, shoqëria nuk ka paraqitur me dokumentacion të rregullt në përmbushje të këtij kriteri asnjë kamion.
- Paraqitjen e 3 kamionëve me kapacitet mbajtës min 12 ton dhe max 17 ton pasi nga 3 (tre) kamiona të kërkuar, shoqëria nuk ka paraqitur me dokumentacion të rregullt në përmbushje të këtij kriteri asnjë kamion.

Gjykojmë se është barrë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, të vërtetojë se disponon kapacitetet teknike në lidhje **me mjetet**. Sqarojmë se, kriteri për mjetet duhet parë dhe vlerësuar në tërësinë e tij, me të gjithë elementët e kërkuar dhe përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit. Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës. Në rastin konkret, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron kapacitetet teknike (makineritë), në përputhje me volumin e përcaktuar

në dokumentat e tenderit. Në këto kushte, vlerësojmë se kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor në pikën 14 të shtojcës 12, “Kapaciteti teknik”, në dokumentat standarte të tenderit, nuk mund të konsiderohet i përmbushur, në lidhje me kamionat me kapacitet mbajtës min 3,5 dhe max 5 kamionat vetshkarkues me kapacitet mbajtës min 12 dhe max 17 ton. si dhe kamioncinat 1.5 – 2 ton.

Për sa më sipër Dokumentacioni i paraqitur nga Operatori Ekonomik “është i paplotë pasi nuk ka përmbushur kriteret e Veçanta të Kualifikimit/ Kapaciteti Teknik nuk zotëron kapacitet të mjaftueshem teknik për sa i përket mjeteve për të realizuar kontratën për këtë objekt prokurimi duke mos përmbushur Kriteret e veçanta për kualifikim, Kapaciteti Teknik dhe profesional, , cka bie në kundërshtim me pikën 1 gërma (a) dhe (b) të nenit 46 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar ku përcaktohet se: *Operatorët ekonomik, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtëme që AK i vlerëson të nevojshme.....*

Pra sa më sipër cituar dokumentacioni i paraqitur nga Operatori Ekonomik lidhur me shtojcën 10, është i paplotë

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar dhe mbështetje të Kreu VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **e shpall të pavlefshme** këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

4. Oferta e paraqitur nga operatori ekonomik “Kupa” sh.p.k me ofertë 22.922.106 (njëzet e dy milion e nëntëqind e njëzet e dy mijë e njëqind e gjashtë) lekë pa tvsh.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi realizoi kontrollin për gabime aritmetike të ofertës së paraqitur në tender në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar neni 66, konstatoi se oferta është paraqitur pa gabime aritmetike në vlera.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të nenit 53 të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe Kreut VII, neni 66, pika 3 të VKM Nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga ky Operator ekonomik, nga ku rezultoi si më poshtë:

Së pari në kriteret e veçanta të kualifikimit është kërkuar si më poshtë cituar:

Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar si staf mbështetës për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, me deshmi kualifikimi profesional të leshuar nga subjektet e akredituar, si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit stafi si më poshtë:

- 2 (dy) hidraulik
- 1 (një) saldator
- **1 (një) elektrikist**
- 1 (një) specialist per montim tubash

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjatë shqyrtimit të dokumentacionit në sistemin elektronik vëren se në përmbushje të kriterit të kërkuar në DST operatori ekonomik ka paraqitur :

1.L.H shoqëruar me kontratë pune (hidraulik) me dëshmi të kualifikimit të sigurimit teknik. si dhe me dëshmi kualifikimi profesional

2.S.D shoqëruar me kontratë pune (hidraulik) me dëshmi të kualifikimit të sigurimit teknik. si dhe me dëshmi kualifikimi professional.

3.A.Q shoqëruar me kontratë pune (saldator) me dëshmi të kualifikimit të sigurimit teknik. si dhe me dëshmi kualifikimi professional.

4. B.P shoqëruar me kontratë pune (specialist montim tubash) me dëshmi të kualifikimit të sigurimit teknik. si dhe me dëshmi kualifikimi professional.

5.A.M shoqëruar me kontratë pune (specialist montim tubash) me dëshmi të kualifikimit të sigurimit teknik. si dhe me dëshmi kualifikimi professional.

6. A.S shoqëruar me kontratë pune (elektriçist) me dëshmi të kualifikimit të sigurimit teknik. si dhe me dëshmi kualifikimi professional për (punime ne lartesi D.P.I.Renia nga lartesia).

Në përmbushje të kriterit të sipërcituar operatori ekonomik ka paraqitur në sistemin elektronik kontratë pune me Z.A.S datë 10.10.2019 punësuar si elektriçist shoqëruar me çerfikatë profesionale me për punime ne lartesi D.P.I.Renia nga lartesia.

Komisioni I Vlerësimit të Ofertave gjykon se operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të kishte paraqitur çertifikatë i cili të provonte se punonjësi Z.A.S është certifikuar/aftësuar për detyrën elektriçist.

Nisur nga sa më lart, KVO gjykon dhe vlerëson se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi nuk është i plotë dhe në përputhje me kriterin e kualifikimit pasi nuk ka arritur të paraqesë dëshmi profesionale për 1 punonjës elektriçist.

Gjykojmë se është barrë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, të vërtetojë se disponon kapacitetet teknike në lidhje me stafin teknik.

Përsa më sipër operatori ekonomik nuk përmbush numrin e kërkuar në DST çka bie në kundërshtim me kushtet e vendosura nga AK kualifikimit profesional për llojet e profesioneve të sipërcituara kriter ky i kërkuar në DST.

Pra sa më sipër Shoqëria **Kupa sh.p.k** nuk zotëron kapacitet të mjaftueshem teknik për sa i përket **personelit të nevojshëm** për të realizuar kontratën për këtë objekt prokurimi duke mos përmbushur Kriteret e veçanta për kualifikim, Kapaciteti Teknik dhe profesional, , çka bie në kundërshtim me pikën 1 gërma (a) dhe (b) të nenit 46 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar ku përcaktohet se: **Operatorët ekonomik, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtëme që AK i vlerëson të nevojshme.....**

Së dyti AK ka kërkuar në kriteret e veçanta të kualifikimit si më poshtë cituar:

14.Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratë (Shtojca 10).

Mjetet	Sasia	Gjendja
Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 3.5(tre pike pese) ton dhe maksimumi 5 (pese) ton për secilin kamion	3 copë	Pronësi ose me qera
Fadrome me goma	1 copë	Pronësi ose me qera
Eskavator me goma 0.25 m3	1 copë	Pronësi ose me qera
Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 12(dymbëdhjetë) ton dhe maksimumi 17(shtatëmbëdhjetë) ton për secilin kamion	3 copë	Pronësi ose me qera
Autobot uji	1 copë	Pronësi ose me qera
Autobetoniere	1 copë	Pronësi ose me qera
Autovinc	1 cope	Pronësi ose me qera
Pompë uji	1 copë	Pronësi ose me qera
Kamionçine (kapaciteti mbajtës minimum 1.5(nje pik pesë) ton dhe maksimumi 2(dy) ton për secilin kamionçinë	4 cope	Pronësi ose me qera
Vibrator	1 cope	Pronësi ose me qera
Matrapik	1 cope	Pronësi ose me qera
Motogjenerator	1 cope	Pronësi ose me qera
Saldatrice	1 cope	Pronësi ose me qera

Te paraqiten mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit si më poshtë:

- Kokore minimumi 60 copë
- Rripa lidhës sigurimi për punime në lartësi minimumi 5 copë
- Fikëse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra secila minimumi 5 copë
- Prozhektorë ndriçimi natën minimumi 4 copë
- Komplet i ndimës së shpejtë minimumi 5 copë
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 10 copë

- Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, Çertifikatë për transport mallrash për llogari të vetë dhe siguracionin e mjetit (te vlefshme), dhe për mjetet e siguruara me qera, dokumenti që verteton regjistrimin e tij plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit,(te vlefshme) Çertifikatë për transport mallrash për të tretë dhe me qera brenda vendit, duhet të shoqerohet me kontraten perkatese te qerases/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi. Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jone aktet e çdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.*
- Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre.*
- Për mjetet e marra me qera të të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj.*
- Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe*

targa e mjetit.

- e) Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara sipas shtojcës Nr. 10. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese).
- f) Makineritë e mësipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë të deklaruara në procedurat të shpallura fitues nga autoriteti kontraktor, UKT sha. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese ku të deklarohet dhe vendndodhja e mjeteve në pronësi ose me qera me qëllim verifikimi).
- g) (opsion) Do të organizohet një vizitë në kantier deri në datë 16.01.2019 në mënyrë të tillë që Operatorët Ekonomikë të mund të familiarizohen me kushtet lokale. Operatori i interesuar Ekonomik duhet të konfirmojë paraprakisht me shkrim synimin e tij për të marrë pjesë në këtë vizitë. Gjatë vizitës do t'u jepen informacione shtesë e shpjegime. Të gjitha kostot e Operatorëve Ekonomikë që lidhen me vizitën në kantier duhet të mbulohen nga vetë ata. Pa paragjykuar sa më sipër, dhe me kostot e risqet e veta, një operator ekonomik mund t'a vizitojë në çdo kohë vendndodhjen e kantierit, nëse një gjë e tillë është e mundur. Për të organizuar një vizitë në kantier, ju lutem drejtoni një shkresë prane Drejtorisë së Prokurimit UKT sha.

Operatori Ekonomik **Kupa sh.p.k** ka deklaruar në shtojcën nr.10 se disponon mjetet e mëposhtme

- Kamion me targa **AA289XD** me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 16.6 ton **(do konsiderohet i rregullt dhe do futet në kategorinë me kapacitet mbajtës 12-17 ton)**
- Kamionçinë me targa **AA938LP** me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 1,6 ton. **(do konsiderohet i rregullt dhe do futet në kategorinë me kapacitet mbajtës 1.5-2 ton)**
- Autobot uji me targa **AA891HC**
- Autovinç me targa **AA251HR** me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 11 ton.
- Kamionçinë me targa **AA065ID** me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 1,8 ton.
- Kamion me targa **AA937HH** me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 14.1 ton
- Kamion me targa **AA873DN** me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 12.2 ton
- Kamionçinë me targa **AA364JD** me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 4.4 ton.

Mjetet e mësipërme janë siguruar nepermjet kontratës së qerash nr. Rep 9, nr.kol 6/1 nepermjet qeradhensit Pevlaku shpk dhe qeramarresit firma Kupa sh.p.k.

Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit në sistemin elektronik për mjetet e mësipërme operatori ekonomik ka paraqitur leje qarkullimi, çertifikatë e kontrollit teknik, taksë vjetore, foto të mjetit si dhe çertifikatë për transport mallrash për llogari të vet.

Ajo çka konstaton Komisioni i Vlerësimit të Ofertave është se çertifikatat e lëshuar nga njësi vendore për transport mallrash është cilësuar "Për llogari të vet, pra qeradhënësi e ka për përdorim

vetjak.

Dhënia e tyre me qera është në kundërshtim me përcaktimet në nenin 81, pika 1,2,3,4,5 dhe 7,8 “Destinacioni dhe Përdorimi i Mjeteve” i ligjit nr.8378 datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenin 3, paragrafi 3.13 dhe 3.14 të Ligjit nr.8308, datë 18.3.1998 për “Transportet rrugore”, si dhe në nenin 41, të Ligjit nr.8308, datë 18.3.1998 për “Transportet rrugore”, ku parashikohet se: “Transporti i mallrave me qira dhe për të tretë është i ndaluar të kryhet pa licencën përkatëse.

- Kamion me targa **AA866RM** me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 5.3 ton
Mjeti i mesiperm është siguruar nepermjet kontrates se qerese nr. Rep 252, nr.kol 92 nepermjet qeradhensit Onyx shpk dhe qeramarresit firma Kupa sh.p.k.

Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit në sistemin elektronik për mjetet e mësipërme operatori ekonomik ka paraqitur leje qarkullimi, çertifikatë e kontrollit teknik, taksë vjetore, foto të mjetit si dhe çertifikatë për transport mallrash për llogari të vet.

Ajo çka konstaton Komisioni i Vlerësimit të Ofertave është se çertifikatat e lëshuar nga njësia vendore për transport mallrash është cilësuar “Për llogari të vet, pra qeradhënësi e ka për përdorim vetjak.

Dhënia e tyre me qera është në kundërshtim me përcaktimet në nenin 81, pika 1,2,3,4,5 dhe 7,8 “Destinacioni dhe Përdorimi i Mjeteve” i ligjit nr.8378 datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenin 3, paragrafi 3.13 dhe 3.14 të Ligjit nr.8308, datë 18.3.1998 për “Transportet rrugore”, si dhe në nenin 41, të Ligjit nr.8308, datë 18.3.1998 për “Transportet rrugore”, ku parashikohet se: “Transporti i mallrave me qira dhe për të tretë është i ndaluar të kryhet pa licencën përkatëse.

- Kamionçinë me targa **AA603FT** me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 1,8 ton. **(do konsiderohet i rregullt dhe do futet në kategorinë me kapacitet mbajtës 1.5-2 ton)**
 - Kamionçinë me targa **DR9043D** me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 1,7 ton.
 - Kamionçinë me targa **DR0532E** me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 4.29 ton.
- Mjetet e mesipërme janë siguruar nepermjet kontrates se qerese nr. Rep 11, nr.kol 8/1 nepermjet qeradhensit Liqeni VII shpk dhe qeramarresit firma Kupa sh.p.k.

Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit në sistemin elektronik për mjetet e mësipërme operatori ekonomik ka paraqitur leje qarkullimi, çertifikatë e kontrollit teknik, taksë vjetore, foto të mjetit si dhe çertifikatë për transport mallrash për llogari të vet.

Ajo çka konstaton Komisioni i Vlerësimit të Ofertave është se çertifikatat e lëshuar nga njësia vendore për transport mallrash është cilësuar “Për llogari të vet, pra qeradhënësi e ka për përdorim vetjak.

Dhënia e tyre me qera është në kundërshtim me përcaktimet në nenin 81, pika 1,2,3,4,5 dhe 7,8 “Destinacioni dhe Përdorimi i Mjeteve” i ligjit nr.8378 datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës

së Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenin 3, paragrafi 3.13 dhe 3.14 të Ligjit nr.8308, datë 18.3.1998 për “Transportet rrugore”, si dhe në nenin 41, të Ligjit nr.8308, datë 18.3.1998 për “Transportet rrugore”, ku parashikohet se: “Transporti i mallrave me qira dhe për të tretë është i ndaluar të kryhet pa licencën përkatëse.

- Kamionçinë me targa **AA426CZ** me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 1,63 ton.

Mjeti i mesiperm është siguruar nepermjet kontrates se qerase nr. Rep 10, nr.kol 7/1 nepermjet qeradhensit Riviera 2008 shpk dhe qeramarresit firma Kupa sh.p.k.

Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit në sistemin elektronik për mjetet e mësipërme operatori ekonomik ka paraqitur leje qarkullimi, çertifikatë e kontrollit teknik, ,taksë vjetore,foto të mjetit si dhe çertifikatë për transport mallrash për llogari të vet.

Ajo çka konstaton Komisioni i Vlerësimit të Ofertave është se çertifikatat e lëshuar nga njësia vendore për transport mallrash është cilësuar “Për llogari të vet, pra qeradhënësi e ka për përdorim vetjak.

Dhënia e tyre me qera është në kundërshtim me përcaktimet në nenin 81, pika 1,2,3,4,5 dhe 7,8 “Destinacioni dhe Përdorimi i Mjeteve” i ligjit nr.8378 datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenin 3, paragrafi 3.13 dhe 3.14 të Ligjit nr.8308, datë 18.3.1998 për “Transportet rrugore”, si dhe në nenin 41, të Ligjit nr.8308, datë 18.3.1998 për “Transportet rrugore”, ku parashikohet se: “Transporti i mallrave me qira dhe për të tretë është i ndaluar të kryhet pa licencën përkatëse.

Sa më sipër cituar operatori ekonomik nuk i përmbush kriterin e përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit për:

- Paraqitjen e 4 mjeteve me kapacitet mbajtës **min 1,5 ton dhe max 2 ton** pasi ka paraqitur 2 kamionçinë me kapacitetin e kërkuar nga AK.
- Paraqitjen e 3 mjeteve me kapacitet mbajtës **min 3,5 ton dhe max 5 ton** pasi nuk ka paraqitur asnjë kamion me kapacitetin e kërkuar nga AK.
- Paraqitjen e 3 mjeteve me kapacitet mbajtës **min 12 ton dhe max 17 ton** pasi ka paraqitur 1 kamion me kapacitetin e kërkuar nga AK.
- Paraqitjen e 1 Autoboti uji pasi nuk ka paraqitur asnjë kamion me kapacitetin e kërkuar nga AK.
- Paraqitjen e 1 Autovinçi pasi nuk ka paraqitur asnjë kamion me kapacitetin e kërkuar nga AK.

Gjykojmë se është barrë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, të vërtetojë se disponon kapacitetet teknike në lidhje me mjetet. Sqarojmë se, kriteri për mjetet duhet parë dhe vlerësuar në tërësinë e tij, me të gjithë elementët e kërkuar dhe përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit.Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e

duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithëcka në funksion realizimit me sukses të kontratës. Në rastin konkret, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron kapacitetet teknike (makineritë), në përputhje me volumin e përcaktuar në dokumentat e tenderit. Në këto kushte, vlerësojmë se kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor në pikën 14 të shtojcës 12, “Kapaciteti teknik”, në dokumentat standarte të tenderit, nuk mund të konsiderohet i përmbushur, në lidhje me kamionçinat me kapacitet mbajtës min 1,5 ton dhe max 2 ton mjetet me kapacitet 3,5 ton - 5 ton si dhe mjetet me kapacitet min 12 ton-17 ton për mjetin Autoboti uji si dhe për mjetin Autovinçi .

Për sa më sipër Dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik “Kupa”sh.p.k është i paplotë pasi nuk ka përmbushur kriteret e Veçanta të Kualifikimit/ Kapaciteti Teknik nuk zotëron kapacitet të mjaftueshem teknik për sa i përket mjeteve për të realizuar kontratën për këtë objekt prokurimi duke mos përmbushur Kriteret e veçanta për kualifikim, Kapaciteti Teknik dhe profesional, , cka bie në kundërshtim me pikën 1 gërma (a) dhe (b) të nenit 46 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar ku përcaktohet se:*Operatorët ekonomik, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtëme që AK i vlerëson të nevojshme.....*Pra sa më sipër cituar dokumentacioni i paraqitur nga Operatori Ekonomik lidhur me shtojcën 10, është i paplotë.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar dhe mbështetje të Kreut VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **e shpall të pavlefshme këtë ofertë** pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

5. Oferta e paraqitur nga operatori ekonomik “Ndertimi sh.p.k” me ofertë 23.398.593 (njëzet e tre milion e treqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e tre) lekë pa tvsh.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi realizoi kontrollin për gabime aritmetike të ofertës së paraqitur në tender në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”I ndryshuar neni 66, konstatoi se oferta është paraqitur pa gabime aritmetike në vlera.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të nenit 53 të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe Kreut VII, neni 66, pika 3 të VKM Nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga ky Operator ekonomik, nga ku rezultoi si më poshtë:

Së pari AK ka kërkuar në kriteret e veçanta të kualifikimit si më poshtë cituar:

1. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. *Përshkrimin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;*
- b. *Deklaratë për paraqitje oferte të pavarur, sipas Shtojcës 1/1;*
- c. *Sigurim oferte, (nëse është e zbatueshme) sipas Shtojcës 3;*
- ç. *Deklaratë mbi përmbushjen e Specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 5;*
- d. *Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 7;*

dh. Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës Shtojces 8/1;

e. Formular vlerësimi sipas Shtojcës 9;

f. Deklaratë mbi disponueshmërinë e mjeteve sipas Shtojcës 10;

g. Deklaratë mbi kontratat e lidhura apo ne proces, sipas Shtojcës 11;

gj. Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit në sistemin elektronik në përmbushje të kriterit të sipërcituar operatori ekonomik "Ndertimi" sh.p.k nuk ka paraqitur **Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.**

Sa më sipër dokumentacioni i shoqërisë lidhur me këtë pikë mungon.

Së dyti AK ka kërkuar në kriteret e veçanta të kualifikimit si më poshtë cituar:

1. Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

a.Punë të ngjashme për një objekt të vetëm me vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe konkretisht: **12.160.845 (dymbëdhjetë milion e njëqind e gjashtëdhjetë mijë e tetëqind e dyzet e pesë) lekë pa TVSH**, të realizuar gjatë tri viteve të fundit, datë e përlllogaritur nga data e hapjes së ofertave.

b.Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë tre viteve të fundit, është në një vlerë jo më të vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet, datë e përlllogaritur nga data e hapjes së ofertave.

Plotesimi i njerit prej dy kushteve të siperpermendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

- a) Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
 1. Deklaratën sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me:
 2. Kontratë
 3. Situacionin përfundimtar;
 4. Aktin e kolaudimit;
- b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
 1. Deklaratën sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me:
 2. Kontrate;
 3. Leje ndertimi/shfrytëzimi për kryerjen e punimeve
 4. Situacionin përfundimtar;
 5. Akt kolaudimi objekti;
 6. Fatura tatimore për çdo situacion punimesh.

Pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik KVO konstaton se operatori ekonomik nuk ka arritur të paraqesë dokumentacion(**Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:**) për të dëshmuar plotësimin e kriterit të kërkuar në DST.

Evidentimi i mungesës së dokumentacionit të kërkuar në DST , KVO konkludon se operatori nuk plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe legjislacionit në fuqi dhe për rrjedhojë nuk mund të konsiderohet i vlefshëm.

Ne rregullat e prokurimit publik theksohet se , operatorët janë të detyruar të përgatisin ofertat dhe **paraqesin te plote te gjithë dokumentacionin e kerkuar ne DT .**

Moplotësimi qofte edhe i nje kriteri te vetem perben shkak per skualifikim .

Në shtojcën 11 shprehimisht parashikohet se.... **Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.**

Së treti AK ka kërkuar në kriteret e veçanta të kualifikimit si më poshtë cituar:

Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar si staf mbështetës për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, me dëshmi kualifikimi profesional të leshuar nga subjektet e akredituar, si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit stafi si më poshtë:

- 2 (dy) hidraulik
- 1 (një) saldator
- 1 (një) elektrikist
- 1 (një) specialist per montim tubash

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjatë shqyrtimit të dokumentacionit në sistemin elektronik vëren se në përmbushje të kriterit të kërkuar në DST operatori ekonomik ka paraqitur :

1.B.SH shoqëruar me kontratë pune (hidraulik) me dëshmi të kualifikimit të sigurimit teknik.

2.A.B shoqëruar me kontratë pune (hidraulik) me dëshmi të kualifikimit të sigurimit teknik.

3.F.T shoqëruar me kontratë pune (elektrikist) me dëshmi të kualifikimit të sigurimit teknik.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur komisioni i vlerësimit të ofertave evidenton se operatori ekonomik nuk ka arritur të paraqesë dëshmi profesionale ashtu siç është kërkuar në kriteret e veçanta të kualifikimit.

Sqarojmë operatorin ekonomik se dëshmitë e kualifikimit profesional dhe dëshmitë e kualifikimit të sigurimit teknik janë të ndryshme nga njëra tjetra dhe lëshohen nga institucione të ndryshme.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave thekson se kualifikimi i sigurimit teknik bëhet në përputhje me nenin 9 pika 1, gërma a) të ligjit nr.8734, datë 01.07.2001”Për garantimin e sigurisë së punës së

pajisjeve dhe instalimeve elektrike në të cilën parashikohet se....Punëdhënësi merr masat e nevojshme që:

a) përdorimi i pajisjeve elektrike të bëhet nga punëmarrës që kanë përgatitje të

mjaftueshme, të dokumentuar me dëshmi aftësie, e lëshuar nga IPIE-ja ose nga komisioni i miratuar prej saj;

e cila ka të bëjë me trajnimin e punonjësve për përdorimin e pajisjeve elektrike ,pavarësisht profesionit që mund të kenë.

Ndërsa dëshmia e kualifikimit profesional ka të bëjë me profesionin e secilit punonjës të cilat lëshohen nga institucione të ndryshme dhe që në asnjë rast nuk janë të njëjta me ato që lëshojnë dëshmitë e kualifikimit të sigurimit teknik.

Përsa cituam më lart dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik Pepa Group sh.p.k do të konsiderohet i paplotë dhe për rrjedhojë i pavlefshëm.

Në shtojcën 11 shprehimisht parashikohet se....**Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.**

Theksojmë se në një procedurë prokurimi,subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën ekonomike në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me kriteret e kualifikimit të përcaktuara në DST.

Së katërti AK ka kërkuar në kriteret e veçanta të kualifikimit si më poshtë cituar:

14.Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratë (Shtojca 10).

<i>Mjetet</i>	<i>Sasia</i>	<i>Gjendja</i>
Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 3.5(tre pike pese) ton dhe maksimumi 5 (pese) ton për secilin kamion	3 copë	Pronësi ose me qera
Fadrome me goma	1 copë	Pronësi ose me qera
Eskavator me goma 0.25 m3	1 copë	Pronësi ose me qera
Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 12(dymbëdhjetë) ton dhe maksimumi 17(shtatëmbëdhjetë) ton për secilin kamion	3 copë	Pronësi ose me qera
Autobot uji	1 copë	Pronësi ose me qera
Autobetoniere	1 copë	Pronësi ose me qera
Autovinc	1 cope	Pronësi ose me qera
Pompë uji	1 copë	Pronësi ose me qera
Kamionçine (kapaciteti mbajtës minimum 1.5(nje pik pesë) ton dhe maksimumi 2(dy) ton për secilin kamionçinë	4 cope	Pronësi ose me qera
Vibrator	1 cope	Pronësi ose me qera
Matrapik	1 cope	Pronësi ose me qera

Motogjenerator	1 cope	Pronësi ose me qera
Saldatrice	1 cope	Pronësi ose me qera

Te paraqiten mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit si më poshtë:

- Kokore minimumi 60 copë
 - Rripa lidhës sigurimi për punime në lartësi minimumi 5 copë
 - Fikëse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra secila minimumi 5 copë
 - Prozhektorë ndriçimi natën minimumi 4 copë
 - Komplet i ndimës së shpejtë minimumi 5 copë
 - Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 10 copë
- a)** *Për mjetet që shënohen në regjistra publike duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, Çertifikatë për transport mallrash për llogari të vetë dhe siguracionin e mjetit (te vlefshme), dhe për mjetet e siguruar me qera, dokumenti që verteton regjistrimin e tij plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit, (te vlefshme) Çertifikatë për transport mallrash për të tretë dhe me qera brenda vendit, duhet të shoqerohet me kontratën perkatese të qerases/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi. Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jone aktet e çdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.*
- b)** *Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre.*
- c)** *Për mjetet e marra me qera të të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj.*
- d)** *Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.*
- e)** *Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara sipas shtojcës Nr. 10. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese).*
- f)** *Makineritë e mësipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë të deklaruara në procedurat të shpallura fitues nga autoriteti kontraktor, UKT sha. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese ku të deklarohet dhe vendndodhja e mjeteve në pronesi ose me qera me qëllim verifikimi).*
- g)** *(opsion) Do të organizohet një vizitë në kantier deri në date 16.01.2019 në mënyrë të tillë që Operatorët Ekonomikë të mund të familiarizohen me kushtet lokale. Operatori i interesuar Ekonomik duhet të konfirmojë paraprakisht me shkrim synimin e tij për të marrë pjesë në këtë vizitë. Gjatë vizitës do t'u jepen informacione shtesë e shpjegime. Të gjitha kostot e Operatorëve Ekonomikë që lidhen me vizitën në kantier duhet të mbulohen nga vetë ata. Pa paragjykuar sa më sipër, dhe me kostot e risqet e veta, një operator ekonomik mund t'a vizitojë në çdo kohë vendndodhjen e kantierit, nëse një gjë e tillë është e mundur.*
Për të organizuar një vizitë në kantier, ju lutem drejtoni një shkresë prane Drejtorise se Prokurimit UKT sha.

Operatori ekonomik “**Ndertimi**” **sh.p.k** ka deklaruar në shtojcën nr.10 se disponon mjetet e mëposhtme:

- Autovinç me targë AA241RL me kapacitet mbajtës i cili del nga leja e qarkullimit 7.9 ton.
- Kamion me targë AA651 MT me kapacitet mbajtës i cili del nga leja e qarkullimit 25.9 ton.

-Kamion me targë AA978BG me kapacitet mbajtës i cili del nga leja e qarkullimit 11.5 ton.

Mjetet e mesiperme jane siguruar nepermjet kontrates se qerase nr. Rep 5012, nr.kol 3491 nepermjet qeradhensit Sefa H shpk dhe qeramarresit firma Ndertimi sh.p.k.

Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit në sistemin elektronik për mjetet e mësipërme operatori ekonomik ka paraqitur leje qarkullimi, çertifikatë e kontrollit teknik, taksë vjetore, foto të mjetit si dhe çertifikatë për transport mallrash për llogari të vet.

Ajo çka konstaton Komisioni i Vlerësimit të Ofertave është se çertifikatat e lëshuar nga njësia vendore për transport mallrash është cilësuar “Për llogari të vet, pra qeradhënësi e ka për përdorim vetjak.

Dhënia e tyre me qera është në kundërshtim me përcaktimet në nenin 81, pika 1,2,3,4,5 dhe 7,8 “Destinacioni dhe Përdorimi i Mjeteve” i ligjit nr.8378 datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenin 3, paragrafi 3.13 dhe 3.14 të Ligjit nr.8308, datë 18.3.1998 për “Transportet rrugore”, si dhe në nenin 41, të Ligjit nr.8308, datë 18.3.1998 për “Transportet rrugore”, ku parashikohet se: “Transporti i mallrave me qira dhe për të tretë është i ndaluar të kryhet pa licencën përkatëse.

- Kamion me targë AA094KS me kapacitet mbajtës i cili del nga leja e qarkullimit 24.9 ton.

-Kamion me targë AA956RX me kapacitet mbajtës i cili del nga leja e qarkullimit 5.8 ton.

Operatori ekonomik “Ndertimi” sh.p.k ka paraqitur dokumentacion shoqërues në sistemin elektronik për mjetin e meposhtme te cilat nuk jane të deklaruar në shtojcën 10.

-Kamion me targë TR8597L me kapacitet mbajtës i cili del nga leja e qarkullimit 11.5 ton.

-Kamionçinë me targë AA359KA me kapacitet mbajtës i cili del nga leja e qarkullimit 1.1 ton.

-Rimorkio me targë ADR 141 me kapacitet mbajtës i cili del nga leja e qarkullimit 26.8 ton.

-Autobetoniere DB 250S

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjykon dhe verifikon vetëm mjetet që përmban deklarata mbi disponueshmërinë e makinerive të dorëzuar nga operatori ekonomik.

Theksojmë se deklarata mbi disponueshmërinë e mjeteve (sipas listës së mjeteve të kërkuara nga AK) pasqyron të gjitha mjetet që operatori ka ndërmend të angazhojë për realizimin e objektit të prokurimit dhe këto mjete nuk janë të angazhuara në AK të tjera duke krijuar bindjen kështu AK se operatori ekonomik disponon mjetet për realizimin e kontratë objekt prokurimi.

Në kushtet kur operatori ekonomik nuk ka deklaruar mjetet me targa TR8597L, AA359KA, ADR 141, DB 250S, në shtojcën 10 tregon qartazi se operatori ekonomik “Ndertimi” sh.p.k nuk i disponon dhe nuk i zotëon këtë mjete për të realizuar kontratën objekt prokurimi.

Sa më sipër cituar operatori ekonomik nuk i përmbush kriterin e përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit për:

- Paraqitjen e 4 mjeteve me kapacitet mbajtës **min 1,5 ton dhe max 2 ton** pasi nuk ka paraqitur asnjë kamion me kapacitetin e kërkuar nga AK.
- Paraqitjen e 3 mjeteve me kapacitet mbajtës **min 3,5 ton dhe max 5 ton** pasi nuk ka paraqitur asnjë kamion me kapacitetin e kërkuar nga AK.
- Paraqitjen e 3 mjeteve me kapacitet mbajtës **min 12 ton dhe max 17 ton** pasi nuk ka paraqitur asnjë kamion me kapacitetin e kërkuar nga AK.

Gjykojmë se është barrë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, të vërtetojë se disponon kapacitetet teknike në lidhje me mjetet. Sqarojmë se, kriteri për mjetet duhet parë dhe vlerësuar në tërësinë e tij, me të gjithë elementët e kërkuar dhe përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit. Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës. Në rastin konkret, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron kapacitetet teknike (makineritë), në përputhje me volumnin e përcaktuar në dokumentat e tenderit. Në këto kushte, vlerësojmë se kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor në pikën 14 të shtojcës 12, “Kapaciteti teknik”, në dokumentat standarte të tenderit, nuk mund të konsiderohet i përmbushur, në lidhje me kamionat 3.5 – 5 ton, kamionçinat 1.5 – 2 ton dhe kamionat 12 – 17 ton.

Për sa më sipër Dokumentacioni i paraqitur nga Operatori Ekonomik “është i paplotë pasi nuk ka përmbushur kriteret e Veçanta të Kualifikimit/ Kapaciteti Teknik nuk zotëron kapacitet të mjaftueshëm teknik për sa i përket mjeteve për të realizuar kontratën për këtë objekt prokurimi duke mos përmbushur Kriteret e veçanta për kualifikim, Kapaciteti Teknik dhe profesional, , cka bie në kundërshtim me pikën 1 gërma (a) dhe (b) të nenit 46 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar ku përcaktohet se: Operatorët ekonomik, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtëme që AK i vlerëson të nevojshme.....

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 53 pika 5, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu VII, Neni 66 pika 3, e shpall të pavlefshme këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Pra sa më sipër cituar dokumentacioni i paraqitur nga Operatori Ekonomik lidhur me shtojcën 10, është i paplotë.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 53 pika 5, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu VII, Neni 66 pika 3, **e shpall të pavlefshme** këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

7. 6.Oferta e paraqitur nga operatori ekonomik “**Senka**” sh.p.k me vlerë **24.319.791** (njëzet e katër milion e treqind e nëntëmbëdhjetë mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e një) lekë pa tvsh.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi realizoi kontrollin për gabime aritmetike të ofertës së paraqitur në tender në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”I ndryshuar neni 66, konstatoi se oferta është paraqitur pa gabime aritmetike në vlera.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të nenit 53 të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe Kreut VII, neni 66, pika 3 të VKM Nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga ky Operator ekonomik, nga ku rezultoi si më poshtë:

Së pari AK ka kërkuar në kriteret e veçanta të kualifikimit si më poshtë cituar:

1. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Përshkrimin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;*

b. *Deklaratë për paraqitje oferte të pavarur, sipas Shtojcës 1/1;*

c. *Sigurim oferte, (nëse është e zbatueshme) sipas Shtojcës 3;*

ç. ***Deklaratë mbi përmbushjen e Specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 5;***

d. ***Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 7;***

dh. ***Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës Shtojces 8/1;***

e. ***Formular vlerësimi sipas Shtojcës 9;***

f. *Deklaratë mbi disponueshmërinë e mjeteve sipas Shtojcës 10;*

g. ***Deklarate mbi kontratat e lidhura apo ne proces, sipas Shtojcës 11;***

gj. *Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.*

Nga shqyrtimi i dokumentacionit në sistemin elektronik në përmbushje të kriterit të sipërcituar operatori ekonomik “Ndertimi” sh.p.k nuk ka paraqitur, ***Deklaratë mbi përmbushjen e Specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 5; Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 7; Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës Shtojces 8/1; Formular vlerësimi sipas Shtojcës 9; Deklarate mbi kontratat e lidhura apo ne proces, sipas Shtojcës 11;***

Sa më sipër dokumentacioni i shoqërisë lidhur me këtë pikë mungon.

AK ka kërkuar gjithashtu në dokumentat standarte te tenderit/kriteret e veçanta të kualifikimit si më poshtë cituar:

4.Një punësim mesatar i të paktën 60 (gjashtëdhjetë) personave, për periudhën Dhjetor 2018-Nëntor 2019 të vërtetuar me;

Punonjësit e sipërcituar duhet të jenë të siguruar me ditë të plota pune.

4.1 Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet shoqerore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj; për periudhën Dhjetor 2018- Nëntor 2019.

4.2 List pagesat e punonjesve sipas formatit që kerkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën Dhjetor 2018- Nëntor 2019.

5. Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar si staf teknik për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë, CV, librezat e punës, të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit stafi inxhinierik si më poshtë:

- 1 (një) Inxhinier Ndërtimi
- 1 (një) Inxhinier Hidroteknik
- 1 (një) Inxhinier Elektrik

6. Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë pjesë të stafit të punësuar; të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, Urdhër mjeku, diplomë, CV, librezë pune dhe të figurojnë në listëpagesa për tre muajt e fundit, 1 (një) mjek të përgjithshëm. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) mjek të përgjithshëm.

7. Të ketë në stafin e punonjesve të pasqyruar në list pagesat e shoqërisë për tre muajt e fundit të paktën 8 (tetë) punonjës të pajisur me dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente me të, ku nga këta të jenë të paktën:

- Grupi I- 3 (tre) punonjës
- Grupi II- 2 (dy) punonjës
- Grupi III- 2 (dy) punonjës
- Grupi IV- 1 (një) punonjës

(Për punonjesit e sipërpermendur të paraqiten dëshmitë perkatese të kualifikimit të sigurimit teknik, kontratat e punës të vlefshme)

8. Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar minimalisht 2 (dy) punonjës manovratorë të mjeteve të rënda nga të cilët një automakinist dhe një eskavatorist. Për këto punonjës duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme, dëshmitë e drejtimit (të vlefshme), lëshuar nga institucionet përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për tre muajt e fundit

9. Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar si staf mbështetës për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, me dëshmi kualifikimi profesional të lëshuar nga subjektet e akredituar, si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit stafi si më poshtë:

- 2 (dy) hidraulik
- 1 (një) saldator
- 1 (një) elektrikist
- 1 (një) specialist për montim tubash

10. Shoqëria duhet të paraqesë Certifikatën e cilesisë së punimeve **ISO 9001- 2015** (e vlefshme) ose ekuivalente me të. (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatën ISO sipas zerave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes).

11. Shoqëria duhet të paraqesë Certifikatë **ISO 14001-2015** (e vlefshme) ose ekuivalente me të. (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatën ISO sipas zerave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes).

12. Shoqëria duhet të paraqesë certifikatë **OHSAS 18001-2007** (e vlefshme) ose ekuivalente me të (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave te punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes).

13. Shoqëria duhet të paraqesë certifikatë **ISO 39001 -2012** (e vlefshme) ose ekuivalente me të (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave te punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes)

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik KVO konstaton se operatori ekonomik nuk ka arritur të paraqesë dokumentacion për të dëshmuar plotësimin e kriterëve pika 4,5,6,7,8,9,10,11,12,13 të kërkuar në DST.

Evidentimi i mungesës së dokumentacionit të kërkuar në DST , KVO konkludon se operatori nuk plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe legjislacionit në fuqi dhe për rrjedhojë nuk mund të konsiderohet i vlefshëm.

Ne rregullat e prokurimit publik theksohet se , operatorët janë të detyruar të përgatitin ofertat dhe **paraqesin te plote te gjithe dokumentacionin e kerkuar ne DT .**

Moplotësimi qofte edhe i nje kriteri te vetem perben shkak per skualifikim .

Në shtojcën 11 shprehimisht parashikohet se... **Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.**

Pra sa më sipër **operatori ekonomik “Senka”** shpk nuk zotëron kapacitet të mjaftueshem teknik për sa i përket **personelit të nevojshëm** për të realizuar kontratën për këtë objekt prokurimi duke mos përmbushur Kriteret e veçanta për kualifikim, Kapaciteti Teknik dhe profesional, , cka bie në kundërshtim me pikën 1 gërma (a) dhe (b) të nenit 46 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar ku përcaktohet se: **Operatorët ekonomik, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme që AK i vlerëson të nevojshme.....**

Pra sa më sipër cituar dokumentacioni i paraqitur nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomik lidhur me Kriteret e Veçanta të Kualifikimit/ Kapaciteti pika 4,5,6,7,8,9,10,11,12,13 është i paplotë, **për rrjedhojë i pavlefshëm.**

AK ka kërkuar në dokumentat standarte te tenderit/kriteret e veçanta të kualifikimit si më poshtë cituar:

14. Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratë (Shtojca 10).

Mjetet	Sasia	Gjendja
Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 3.5(tre pike pese) ton dhe maksimumi 5 (pese) ton për secilin kamion	3 copë	Pronësi ose me qera
Fadrome me goma	1 copë	Pronësi ose me qera
Eskavator me goma 0.25 m3	1 copë	Pronësi ose me qera
Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 12(dymbëdhjetë) ton dhe maksimumi 17(shtatëmbëdhjetë) ton për	3 copë	Pronësi ose me qera

secilin kamion		
Autobot uji	1 copë	Pronësi ose me qera
Autobetoniere	1 copë	Pronësi ose me qera
Autovinc	1 cope	Pronësi ose me qera
Pompë uji	1 copë	Pronësi ose me qera
Kamionçine (kapaciteti mbajtës minimum 1.5(nje pik pesë) ton dhe maksimumi 2(dy) ton për secilin kamionçinë	4 cope	Pronësi ose me qera
Vibrator	1 cope	Pronësi ose me qera
Matrapik	1 cope	Pronësi ose me qera
Motogjenerator	1 cope	Pronësi ose me qera
Saldatrice	1 cope	Pronësi ose me qera

Te paraqiten mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit si më poshtë:

- Kokore minimumi 60 copë
- Ripa lidhës sigurimi për punime në lartësi minimumi 5 copë
- Fikëse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra secila minimumi 5 copë
- Prozhektorë ndriçimi natën minimumi 4 copë
- Komplet i ndimës së shpejtë minimumi 5 copë
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 10 copë

- a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, Çertifikatë për transport mallrash për llogari të vetë dhe siguracionin e mjetit (te vlefshme), dhe për mjetet e siguruar me qera, dokumenti që verteton regjistrimin e tij plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit, (te vlefshme) Çertifikatë për transport mallrash për të tretë dhe me qera brenda vendit, duhet të shoqërohet me kontraten perkatese të qerases/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi. Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jone aktet e çdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.
- b) Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre.
- c) Për mjetet e marra me qera të të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj.
- d) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.
- e) Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara sipas shtojcës Nr. 10. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese).
- f) Makineritë e mësipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë të deklaruara në procedurat të shpallura fitues nga autoriteti kontraktor, UKT sha. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese ku të deklarohej dhe vendndodhja e mjeteve në pronësi ose me qera me qellim verifikimi).
- g) (opsion) Do të organizohet një vizitë në kantier deri në datë 16.01.2019 në mënyrë të tillë që Operatorët Ekonomikë të mund të familiarizohen me kushtet lokale. Operatori i interesuar Ekonomik duhet të konfirmojë paraprakisht me shkrim synimin e tij për të marrë pjesë në këtë vizitë. Gjatë vizitës do t'u jepen informacione shtesë e shpjegime. Të gjitha kostot e Operatorëve

Ekonomikë që lidhen me vizitën në kantier duhet të mbulohen nga vetë ata. Pa paragjykuar sa më sipër, dhe me kostot e risqet e veta, një operator ekonomik mund t'a vizitojë në çdo kohë vendndodhjen e kantierit, nëse një gjë e tillë është e mundur.

Për të organizuar një vizitë në kantier, ju lutem drejtoni një shkresë prane Drejtorise se Prokurimit UKT sha.

Operatori ekonomik “Senka ” sh.p.k ka deklaruar në shtojcën nr.10 se disponon mjetet e mëposhtme:

-Kamionçinë me targë AA658TY me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 0.5 ton

- Kamionçinë me targë TR7429T me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 1 ton

-Autovinç me targë AA845CZ me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 5.5 ton

- Autovinç me targë AA864CJ me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 5.9 ton

- Kamion me targë AA918VC me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 16.9 ton(**do konsiderohet i rregullt dhe do futet në kategorinë me kapacitet mbajtës 12-17 ton**)

- Kamion me targë AA698UD me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 16.4 ton(**do konsiderohet i rregullt dhe do futet në kategorinë me kapacitet mbajtës 12-17 ton**)

-Kamion me targë AA338OP me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 17 ton(**do konsiderohet i rregullt dhe do futet në kategorinë me kapacitet mbajtës 12-17 ton**)

-Kamion me targë AA348IX me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 23.7 ton

-Kamion me targë AA347IX me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 23.6 ton

Sa më sipër cituar operatori ekonomik nuk i përmbush kriterin e përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit për:

- Paraqitjen e 4 mjeteve me kapacitet mbajtës **min 1,5 ton dhe max 2 ton** pasi nuk ka paraqitur asnjë kamion me kapacitetin e kërkuar nga AK.
- Paraqitjen e 3 mjeteve me kapacitet mbajtës **min 3,5 ton dhe max 5 ton** pasi nuk ka paraqitur asnjë kamion me kapacitetin e kërkuar nga AK.

Gjykojmë se është barrë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, të vërtetojë se disponon kapacitetet teknike në lidhje me mjetet. Sqarojmë se, kriteri për mjetet duhet parë dhe vlerësuar në tërësinë e tij, me të gjithë elementët e kërkuar dhe përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit. Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit

të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës. Në rastin konkret, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron kapacitetet teknike (makineritë), në përputhje me volumnin e përcaktuar në dokumentat e tenderit. Në këto kushte, vlerësojmë se kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor në pikën 14 të shtojcës 12, “Kapaciteti teknik”, në dokumentat standarte të tenderit, nuk mund të konsiderohet i përmbushur, në lidhje me kamionat 3.5 – 5 ton dhe kamionçinat 1.5 – 2 ton .

Për sa më sipër Dokumentacioni i paraqitur nga Operatori Ekonomik “është i paplotë pasi nuk ka përmbushur kriteret e Veçanta të Kualifikimit/ Kapaciteti Teknik nuk zotëron kapacitet të mjaftueshem teknik për sa i përket mjeteve për të realizuar kontratën për këtë objekt prokurimi duke mos përmbushur Kriteret e veçanta për kualifikim, Kapaciteti Teknik dhe profesional, , cka bie në kundërshtim me pikën 1 gërma (a) dhe (b) të nenit 46 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar ku përcaktohet se:Operatorët ekonomik, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtëme që AK i vlerëson të nevojshme.....

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 53 pika 5, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu VII,Neni 66 pika 3, e shpall të pavlefshme këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Pra sa më sipër cituar dokumentacioni i paraqitur nga Operatori Ekonomik lidhur me shtojcën 10, është i paplotë.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 53 pika 5, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu VII,Neni 66 pika 3, **e shpall të pavlefshme** këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

8. 7. Oferta e paraqitur nga operatori ekonomik **“INA” sh.p.k** me vlerë **21.742.265** (njëzet e një milion e shtatëqind e dyzetë e dy mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e pesë) lekë pa tvsh.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi realizoi kontrollin për gabime aritmetike të ofertës së paraqitur në tender në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”I ndryshuar neni 66, konstatoi se oferta është paraqitur pa gabime aritmetike në vlera.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të Nenit 53 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin Publik”, (i ndryshuar), dhe të Kreut VII Neni 66 pikës 3 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e rregullave të prokurimit publik”,I ndryshuar si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga ky Operator Ekonomik nga ku rezultoi si më poshtë:

Së pari AK ka kërkuar në kriteret e veçanta të kualifikimit kapaciteti teknik pika 9 si më poshtë

Ujësjiellës Kanalizime sh.a. Tiranë NIPT L72320033P Adresa: Rruga e Kavajës Nr.133, Njësia administrative Nr.6,
Kodi postar 1027, Tiranë, Shqipëri, Tel: 00 355 42240978,info@ukt.al.

cituat:

9. Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar si staf mbështetës për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, me dëshmi kualifikimi profesional të lëshuar nga subjektet e akredituar, si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit stafi si më poshtë:

- 2 (dy) hidraulik
- 1 (një) saldator
- **1 (një) elektrikist**
- 1 (një) specialist për montim tubash

Në përmbushje të kriterit të kërkuar në DST operatori ekonomik Ina sh.p.k ka paraqitur në sistemin elektronik punonjësit e mëposhtëm:

1.E.RR shoqëruar me kontratë punë datë 03.01.2020 si dhe I pajisur me dëshmi të kualifikimit të sigurimit teknik.

2.D.M shoqëruar me kontratë punë datë 03.01.2020 si dhe I pajisur me dëshmi të kualifikimit të sigurimit teknik.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur komisioni i vlerësimit të ofertave evidenton se operatori ekonomik nuk ka arritur të paraqesë dëshmi profesionale për profesionin elektrikist ashtu siç është kërkuar në kriteret e veçanta të kualifikimit.

Sqarojmë operatorin ekonomik se dëshmitë e kualifikimit profesional dhe dëshmitë e kualifikimit të sigurimit teknik janë të ndryshme nga njëra tjetra dhe lëshohen nga institucione të ndryshme.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave thekson se kualifikimi i sigurimit teknik bëhet në përputhje me nenin 9 pika 1, gërma a) të ligjit nr.8734, datë 01.07.2001 "Për garantimin e sigurisë së punës së pajisjeve dhe instalimeve elektrike në të cilën parashikohet se....Punëdhënësi merr masat e nevojshme që:

a) përdorimi i pajisjeve elektrike të bëhet nga punëmarrës që kanë përgatitje të

mjaftueshme, të dokumentuar me dëshmi aftësie, e lëshuar nga IPIE-ja ose nga komisioni i miratuar prej saj; e cila ka të bëjë me trajnimin e punonjësve për përdorimin e pajisjeve elektrike, pavarësisht profesionit që mund të kenë.

Ndërsa dëshmia e kualifikimit profesional ka të bëjë me profesionin e secilit punonjës të cilat lëshohen nga institucione të ndryshme dhe që në asnjë rast nuk janë të njëjta me ato që lëshojnë dëshmitë e kualifikimit të sigurimit teknik.

Përsa cituam më lart dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik Ina sh.p.k do të konsiderohet i paplotë dhe për rrjedhojë i pavlefshëm.

Në shtojcën 11 shprehimisht parashikohet se....**Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.**

Theksojmë se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili

e përgatit ofertën ekonomike në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me kriteret e kualifikimit të përcaktuara në DST.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar dhe mbështetje të Kreu VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **e shpall të pavlefshme** këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara

9. 8. Oferta e paraqitur nga operatori ekonomik “BE-IS” sh.p.k me vlerë 20.648.152 (njëzetë milion e gjashtëqind e dyzetë e tetë mijë e njëqind e pesëdhjetë e dy) lekë pa TVSH.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi realizoi kontrollin për gabime aritmetike të ofertës së paraqitur në tender në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”I ndryshuar neni 66, konstatoi se oferta është paraqitur pa gabime aritmetike në vlera.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të Nenit 53 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin Publik”, (i ndryshuar), dhe të Kreut VII Nenit 66 pikës 3 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e rregullave të prokurimit publik”,I ndryshuar si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga ky Operator Ekonomik nga ku rezultoi si më poshtë:

Së pari AK ka kërkuar në kriteret e veçanta të kualifikimit kapaciteti teknik pika 14 si më poshtë cituar:

14.Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratë (Shtojca 10).

<i>Mjetet</i>	<i>Sasia</i>	<i>Gjendja</i>
Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 3.5(tre pike pese) ton dhe maksimumi 5 (pese) ton për secilin kamion	3 copë	Pronësi ose me qera
Fadrome me goma	1 copë	Pronësi ose me qera
Eskavator me goma 0.25 m3	1 copë	Pronësi ose me qera
Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 12(dymbëdhjetë) ton dhe maksimumi 17(shtatëmbëdhjetë) ton për secilin kamion	3 copë	Pronësi ose me qera
Autobot uji	1 copë	Pronësi ose me qera
Autobetoniere	1 copë	Pronësi ose me qera
Autovinc	1 cope	Pronësi ose me qera
Pompë uji	1 copë	Pronësi ose me qera
Kamionçine (kapaciteti mbajtës minimum 1.5(nje pik pesë) ton dhe maksimumi 2(dy) ton për secilin kamionçinë	4 cope	Pronësi ose me qera

Vibrator	1 cope	Pronësi ose me qera
Matrapik	1 cope	Pronësi ose me qera
Motogjenerator	1 cope	Pronësi ose me qera
Saldatrice	1 cope	Pronësi ose me qera

Te paraqiten mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit si më poshtë:

- Kokore minimumi 60 copë
- Ripa lidhës sigurimi për punime në lartësi minimumi 5 copë
- Fikëse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra secila minimumi 5 copë
- Prozhektorë ndriçimi natën minimumi 4 copë
- Komplet i ndimës së shpejtë minimumi 5 copë
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 10 copë

- a) *Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, Çertifikatë për transport mallrash për llogari të vetë dhe siguracionin e mjetit (te vlefshme), dhe për mjetet e siguruar me qera, dokumenti që verteton regjistrimin e tij plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit, (te vlefshme) Çertifikatë për transport mallrash për të tretë dhe me qera brenda vendit, duhet të shoqërohet me kontratën perkatese të qerave/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi. Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jene aktet e çdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.*
- b) *Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre.*
- c) *Për mjetet e marra me qera të të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj.*
- d) *Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.*
- e) *Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara sipas shtojcës Nr. 10. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese).*
- f) *Makineritë e mësipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë të deklaruara në procedurat të shpallura fitues nga autoriteti kontraktor, UKT sha. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese ku të deklarohet dhe vendndodhja e mjeteve në pronësi ose me qera me qëllim verifikimi).*
- g) *(opsion) Do të organizohet një vizitë në kantier deri në datë 16.01.2019 në mënyrë të tillë që Operatorët Ekonomikë të mund të familiarizohen me kushtet lokale. Operatori i interesuar Ekonomik duhet të konfirmojë paraprakisht me shkrim synimin e tij për të marrë pjesë në këtë vizitë. Gjatë vizitës do t'u jepen informacione shtesë e shpjegime. Të gjitha kostot e Operatorëve Ekonomikë që lidhen me vizitën në kantier duhet të mbulohen nga vetë ata. Pa paragjykuar sa më sipër, dhe me kostot e risqet e veta, një operator ekonomik mund t'a vizitojë në çdo kohë vendndodhjen e kantierit, nëse një gjë e tillë është e mundur. Për të organizuar një vizitë në kantier, ju lutem drejtoni një shkresë prane Drejtorisë së Prokurimit UKT sha.*

Operatori ekonomik BE-IS sh.p.k ka deklaruar në shtojcën nr.10 se për të realizuar kontratën objekt prokurimi se disponon mjetet e mëposhtme:

Ujësjiellës Kanalizime sh.a. Tiranë NIPT L72320033P Adresa: Rruga e Kavajës Nr.133, Njësia administrative Nr.6, Kodi postar 1027, Tiranë, Shqipëri, Tel: 00 355 42240978, info@ukt.al.

Per te permbushur kriterin kamion me kapacitet mbajtes min 3,5 ton- max 5 ton për kamion vetëshkarkues (3 copë) operatori ekonomik ka paraqitur mjetet e mëposhtme:

- Kamion me targa AA108HK me kapacitet mbajtësi i cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 3,475 ton mjet i cili do të konsiderohet në rregull dhe do të klasifikohet në kategorinë e mjeteve min 3,5-max 5 ton.
- Kamion me targa AA782FA me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 4,1 ton mjet i cili do të konsiderohet i rregullt dhe do të futet në kategorinë e mjeteve min 3,5 ton –max 5 ton.
- Kamion me targa AA023PM me kapacitet mbajtës i cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 4,36 ton mjet i siguruar nëpërmjet kontratës së qerasë datë 19.12.2019.

Komisioni i Vlerësimit të ofertave gjatë shqyrtimit të dokumentacionit në sistemin elektronik për mjetin me targa AA023PM (mjet i siguruar me kontrata qeraje nga operatori ekonomik Beis sh.p.k) vëren se në përmbushje të kushteve të veçanta të kualifikimit të kërkuar në DST operatori ekonomik ka paraqitur leje qarkullimi, çertifikatë e kontrollit teknik, ,taksë vjetore,foto të mjetit,çertifikatë për transport mallrash për llogari të vet.

Ajo çka konstaton Komisioni i Vlerësimit të Ofertave është se çertifikata e lëshuar për mjetin e mësipërm nga njësia vendore për transport mallrash janë cilësuar “Për llogari të vet, pra qeradhënësi e ka për përdorim vetjak.

Dhënia e tyre me qera është në kundërshtim me përcaktimet në nenin 81, pika 1,2,3,4,5 dhe 7,8 “Destinacioni dhe Përdorimi i Mjeteve” i ligjit nr.8378 datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenin 3, paragrafi 3.13 dhe 3.14 të Ligjit nr.8308, datë 18.3.1998 për “Transportet rrugore”, si dhe në nenin 41, të Ligjit nr.8308, datë 18.3.1998 për “Transportet rrugore”, ku parashikohet se: “Transporti i mallrave me qira dhe për të tretë është i ndaluar të kryhet pa licencën përkatëse.

Sa më sipër cituar operatori ekonomik nuk e përmbush kriterin e përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit për:

- Paraqitjen e 3 mjeteve me kapacitet mbajtës **min 3,5 ton dhe max 5 ton** pasi nga 3 mjete të kërkuara nga AK ka paraqitur vetëm 2 mjete të saktë sipas dokumentacionit të kërkuar.

Per te permbushur kriterin kamion me kapacitet mbajtes min 12 ton- max 17 ton për kamion vetëshkarkues (3 copë) operatori ekonomik ka paraqitur mjetet e mëposhtme:

- Kamion me targa AA944RH me kapacitet mbajtësi i cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 15.1 ton mjet i siguruar nëpërmjet kontratës së qerasë datë 17.01.2020.
- Kamion me targa AA461OX me kapacitet mbajtësi i cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 16 ton mjet i siguruar nëpërmjet kontratës së qerasë datë 18.01.2020.
- Kamion me targa AA367HC me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 14,375 ton mjet i cili do të konsiderohet i rregullt dhe do të futet në kategorinë e mjeteve min 12 ton –max 17 ton.

Komisioni i Vlerësimit të ofertave gjatë shqyrtimit të dokumentacionit në sistemin elektronik për

mjetet me targa AA944RH dhe AA461OX (mjete të siguruar me kontrata qeraje nga operatori ekonomik Beis sh.p.k) vëren se në përmbushje të kushteve të veçanta të kualifikimit të kërkuar në DST operatori ekonomik ka paraqitur leje qarkullimi, çertifikatë e kontrollit teknik, ,taksë vjetore,foto të mjetit,çertifikatë për transport mallrash për llogari të vet.

Ajo çka konstaton Komisioni i Vlerësimit të Ofertave është se çertifikatat e lëshuara për mjetet e mësipërme nga njësia vendore për transport mallrash janë cilësuar “Për llogari të vet, pra qeradhënësi e ka për përdorim vetjak.

Dhënia e tyre me qera është në kundërshtim me përcaktimet në nenin 81, pika 1,2,3,4,5 dhe 7,8 “Destinacioni dhe Përdorimi i Mjeteve” i ligjit nr.8378 datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenin 3, paragrafi 3.13 dhe 3.14 të Ligjit nr.8308, datë 18.3.1998 për “Transportet rrugore”, si dhe në nenin 41, të Ligjit nr.8308, datë 18.3.1998 për “Transportet rrugore”, ku parashikohet se: “Transporti i mallrave me qira dhe për të tretë është i ndaluar të kryhet pa licencën përkatëse.

Sa më sipër cituar operatori ekonomik nuk e përmbush kriterin e përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit për:

- Paraqitjen e 3 mjeteve me kapacitet mbajtës **min 12 ton dhe max 17 ton** pasi nga 3 mjete të kërkuara nga AK ka paraqitur vetëm 1 mjet të saktë sipas dokumentacionit të kërkuar.

Për të përmbushur kriterin me kapacitet mbajtës min 1,5 ton- max 2 ton për secilin kamionçinë (4 copë) operatori ekonomik Beis sh.p.k ka paraqitur mjetet e mëposhtme::

- Mjeti me targa AA057NZ me kapacitet mbajtës cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 0,99 ton.
- Mjeti me targa AA079JX me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 1,36 ton.
- Mjeti me targa AA384YJ me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 0,99 ton.
- Mjeti me targa DR9836D me kapacitet mbajtësi i cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 1,6 ton mjet i cili do të konsiderohet i rregullt dhe do të futet në kategorinë e mjeteve min 1,5 ton –max 2 ton.
- Mjeti me targa AA657JY me kapacitet mbajtësi i cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 1,53 ton mjet i cili do të konsiderohet i rregullt dhe do të futet në kategorinë e mjeteve min 1,5 ton –max 2 ton.
- Mjeti me targa AA193SA me kapacitet mbajtësi i cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 2,35 ton.
- Mjeti me targa AA137NE mjet i deklaruar në shtojcën 10(mbi disponimin e makinerive).

Nga shqyrtimi i dokumentacionit në sistemin elektronik për mjetin me targa AA137NE KVO vëren se operatori ekonomik Beis sh.p.k nuk ka arritur të paraqesë dokumentacion shoqërues për mjetin e sipërcituar përkatësisht leje qarkullimi,policë sigurimi,çertifikatë e kontrollit teknik çka bie në kundërshtim me kushtet e përcaktuara në DST.

Sa më sipër cituar operatori ekonomik nuk e përmbush kriterin e përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit për:

Ujësjiellës Kanalizime sh.a. Tiranë NIPT L72320033P Adresa: Rruga e Kavajës Nr.133, Njësia administrative Nr.6, Kodi postar 1027, Tiranë, Shqipëri, Tel: 00 355 42240978,info@ukt.al.

- Paraqitjen e 4 mjeteve me kapacitet mbajtës **min 1,5 ton dhe max 2 ton** pasi nga 4 mjete të kërkuara nga AK ka paraqitur vetëm 2 mjete të sakta sipas tonazhit të kërkuar.

Për të përmbushur kriterin e kërkuar përkatësisht mjetin Autobot Uji (1 copë) operatori ekonomik ka paraqitur mjetin e mëposhtëm:

-Mjeti me targë AA473SA mjet i siguruar nga operatori ekonomik Beis sh.p.k me anë të kontratës së qerasë datë 17.01.2020.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjatë shqyrtimit të dokumentacionit në sistemin elektronik për mjetin me targë AA473SA vëren se në përmbushje të kushteve të veçanta të kualifikimit të kërkuar në DST operatori ekonomik ka paraqitur leje qarkullimi, çertifikatë e kontrollit teknik, ,taksë vjetore,foto të mjetit,çertifikatë për transport mallrash për llogari të vet.

Ajo çka konstaton Komisioni i Vlerësimit të Ofertave është se çertifikata e lëshuar për mjetin e mësipërm nga njësia vendore për transport mallrash janë cilësuar “Për llogari të vet, pra qeradhënësi e ka për përdorim vetjak.

Dhënia e tyre me qera është në kundërshtim me përcaktimet në nenin 81, pika 1,2,3,4,5 dhe 7,8 “Destinacioni dhe Përdorimi i Mjeteve” i ligjit nr.8378 datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenin 3, paragrafi 3.13 dhe 3.14 të Ligjit nr.8308, datë 18.3.1998 për “Transportet rrugore”, si dhe në nenin 41, të Ligjit nr.8308, datë 18.3.1998 për “Transportet rrugore”, ku parashikohet se: “Transporti i mallrave me qira dhe për të tretë është i ndaluar të kryhet pa licencën përkatëse.

Sa më sipër cituar operatori ekonomik nuk e përmbush kriterin e përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit për:

- Paraqitjen e 1 mjeti Autobot Uji pasi nga 1 mjet i kërkuar nga AK nuk ka paraqitur asnjë mjet të saktë sipas dokumentacionit të kërkuar.

Për sa më sipër Dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik “Beis”sh.p.k është i paplotë pasi nuk ka përmbushur kriteret e Veçanta të Kualifikimit/ Kapaciteti Teknik nuk zotëron kapacitet të mjaftueshem teknik për sa i përket mjeteve për të realizuar kontratën për këtë objekt prokurimi duke mos përmbushur Kriteret e veçanta për kualifikim, Kapaciteti Teknik dhe profesional, , çka bie në kundërshtim me pikën 1 gërma (a) dhe (b) të nenit 46 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar ku përcaktohet se:*Operatorët ekonomik, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtëme që AK i vlerëson të nevojshme.....*

Pra sa më sipër cituar dokumentacioni i paraqitur nga Operatori Ekonomik lidhur me shtojcën 10, është i paplotë.

Në shtojcën 11 shprehimisht parashikohet se....**Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.**

Theksojmë se në një procedurë prokurimi,subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën ekonomike në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me kriteret e

kualifikimit të përcaktuara në DST.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar dhe mbështetje të Kreu VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e shpall të pavlefshme këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë, Operatori ekonomik “**ARB & TRANS-2010**” sh.p.k me NIPT L02325001T, me administrator Z. Fatmir Firi, me seli në Adresën: Tirane,Zall Herr Cerkeze-Morine,Ndertese 2 kateshe, 100 m larg ish Stallave Çekreze, me vlerë të ofertës: **21.883.853,4** (njëzet e nje milion e tetëqind e tetëdhjetë e tre mijë e tetëqind e pesëdhjetë e tre presje katër) lekë pa TVSH, **se është identifikuar si oferta e suksesshme.**

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Ujësjiellës Kanalizime Tiranë sh.a me adresë Rruga e Kavajës Nr.133, Njësia administrative Nr.6, Kodi postar 1027, Tiranë, Shqipëri, me nr tel: +355 4 2225572, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga dita e marrjes të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 28.01.2020

Ankesa: Nuk ka patur.

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

REDI MOLLA